



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VOĐE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Raporti i Punës për Vitin – 2025

Mars 2026

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	2
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2. KORNIZA LIGJORE	5
3. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I ARRU	6
3.1 MISIONI DHE VIZIONI I ARRU-SË	6
3.2 VIZIONI	6
3.3 PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ARRU-SË	6
4. FUSHËVEPRIMI I ARRU	8
4.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE E ARRU	11
4.2 BORDI I DREJTORËVE	14
4.3 EKZEKUTIVI I ARRU	14
4.4 BURIMET NJERËZORE	15
4.5 ASETET	15
5. AKTIVITETET PËR PERIUdhËN RAPORTUESE	16
5.1 AKTIVITETET E REALIZUARA NË VITIN 2025	16
6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET	46
7. RAPORTI FINANCIAR	48
7.1 TË HYRAT	48
7.2 BUXHETI	488
7.3 SHPENZIMET BUXHETORE	49
8. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	50
SHTOJCA 1: TË DHËNAT E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT	51
SH-1.1: ANKESAT E KONSUMATORËVE	51
SH-1.2: TREGUESIT E PERFORMANCËS TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT	52
SHTOJCA 3: TARIFAT PËR UJË DHE UJËRA TË NDOTUR	62

LISTA E SHKURTESAVE

ARRU	– Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BD	– Bordi i Drejtorëve të KRU-ve
IKSHPK	– Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IAWD	– Shoqata Ndërkombëtare e Ujit të Danubit
IBNET	– Rrjeti Ndërkombëtar i Bechmarkingut
NJPMNP	– Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
Nj-I	– Njësia për inspektim
ME	– Ministria e Ekonomisë
MIE	– Ministria e Integriteteve Evropiane
MEF	– Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MMPHI	– Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MTIN	– Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë
KRU	– Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit
KEINT	– Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndrëmarrësi dhe Tregti
KZA	– Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave
UPF	– Uji i Pa Faturuar
PMA	– Plani i menaxhimit të asetëve
PB	– Plani i Biznesit
D-ÇL&L	– Departamenti për çështje ligjore dhe licencim
D-RP	– Departamenti për raportim dhe performancë
D-AF	– Departamenti për administratë dhe financa
D-T	– Departamenti për tarifa
DANUBIS	– Programi i Bechmarkingut të Vendeve të Regjionit të Danubit
ERRU	– Enti Rregullator i Ujit të Shqipërisë
QK	– Qeveria e Kosovës
QRSHP	– Qendrat Regjionale të Shëndetit Publik
GIS	– Sistemi informativ gjeografik
SCO	– Zyra Zvicerane për Zhvillim
SHUKOS	– Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
SKZH	– Strategjia kombëtare për zhvillim
ZD	– Zëvendës Drejtori i ARRU
ZMP	– Zyrtar për Marëdhënie me Publikun
WAREG	– European Water Regulators (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit)

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU), sipas Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ligjit nr. 06/l - 088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është Autoritet i pavarur me mandat për rregullimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm, të ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë.

Roli dhe mandati i ARRU është që të monitorojë dhe të sigurojë që Kompanitë Regjionale të Ujit (KRU-të) ofrojnë shërbimeve cilësore, eficiente, dhe të sigurt në baza jo-diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh para së gjithash, mbrojtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

ARRU ka përgjegjësinë për të zhvilluar dhe avancuar kornizën rregullatore, plotësimin dhe avancimin me standarde të reja për të siguruar që KRU-të e licencuara të ofrojnë furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime të ujërave të ndotura në mënyrë efikase dhe me kosto të përballueshme për të gjithë konsumatorët brenda zonës së shërbimit.

Ky raport përmbledh aktivitetet e realizuara të ARRU gjatë vitit 2025 (1 Janar 2025 deri 31 Dhjetor 2025), përfshirë raportin financiar të ARRU-së. Në shtojcë të raportit janë përmbledhur në formë tabelash dhe grafikonesh disa tregues kryesor që ilustron performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit & ujërave të ndotur dhe tarifat e aplikueshme për vitin kalendarik 2025.

Përveç obligimit ligjor për hartim dhe dorëzim të Raportit Vjetor të Punës së ARRU-së për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ky raport synon të jetë një burim shtesë informacioni për publikun dhe palët e interesit. ARRU, në kuadër të mandatit të saj ligjor, publikon të gjitha raportet, urdhëresat dhe të dhënat tjera lidhur me aktivitetet dhe performancën e sektorit në web-faqen e saj <http://www.arru-rks.org>.

Falë angazhimit të stafit dhe bashkëpunimit të mirë me KRU-të dhe palët tjera të interesit, ARRU ka arritur të realizojë obligimin e saj ligjor, të përmbushë synimet strategjike dhe aktivitetet e planifikuara në Planin e Performancës (Planin e Punës) për vitin 2025 në nivel të kënaqshëm.

Prej vitit 2024 ka filluar së zbatuari Plani Strategjik i ARRU-së 2024-2026, në të cilin janë përcaktuar 6 (gjashtë) Synime Strategjike, të cilat burojnë nga mandati dhe përgjegjësitë ligjore që i ka ARRU. Përmes këtyre Synimeve Strategjike, ARRU synon të avancojë më tutje cilësinë e shërbimeve të sektorit të ujit në përgjithësi. Synimet Strategjike të definuar në Planin Strategjik 2024-2026 janë dhënë në vijim:

Synimi Strategjik 1: Korniza ligjore dhe rregullative është në përkrahje të zhvillimit të qëndrueshëm të ofruesve të shërbimeve dhe e balancuar me kërkesat e konsumatorëve.

Synimi Strategjik 2: Menaxhimi dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e infrastrukturës së shërbimeve të ujit sigurohet përmes procesit tarifor.

Synimi Strategjik 3: Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimeve kundrejt caqeve të aprovuara, udhëhequr në praktikën e benchmarkingut dhe konkurrencës.

Synimi Strategjik 4: Monitorimi dhe inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe besueshmërisë së të dhënave;

Synimi Strategjik 5: Nxitja e zhvillimit institucional të ARRU-së, mirëmbajtja dhe krijimi i partneritetit për t'u përballur me sfidat në rritje të sektorit;

Synimi Strategjik 6: Sigurimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU.

Në Shtojcë të Raportit të Punës, për informatë të anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti rreth performimit të sektorit, janë dhënë disa tregues të performancës së përgjithshme të sektorit të ujit.

2. KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është themeluar me Ligjin nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Ky ligj përcakton kornizën për rregullimin ekonomik të kompanive publike që ofrojnë furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime të ujërave të ndotura në Kosovë, si dhe, përcakton përgjegjësitë dhe autorizimet e ARRU, si rregullator i pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në bazë të këtij ligji ARRU ka nxjerrë aktet normative sekondare, në bazë të cilave është rregulluar veprimtaria dhe janë specifikuar detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e të gjitha palëve (ARRU, ofruesve të shërbimeve, konsumatorëve, etj.).

Baza ligjore dhe rregullative sipas së cilës funksionon ARRU është definuar me:

- Ligjin Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të Ujit dhe Ligji Nr. 06/l-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

ARRU, ka kompletuar më tej përgjegjësit, funksionet dhe procedurat e punës, përmes legjislacionit dytësor (rregulloreve) të përmbledhura si në vijim:

- Rregullore Nr. 16/2025 për licencimin dhe kushtet e licencës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë,
- Rregullore e plotësuar dhe ndryshuar Nr. 15/2025 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve,
- Rregullore Nr. 13/2021 për Kartën e Konsumatorit dhe Rregullimin e Marrëdhënieve Juridike në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit,
- Rregullore Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr.10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr. 11/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 03/2016, rregullores nr. 04/2016, rregullores nr. 05/2016, rregullores nr. 06/2016 dhe rregullores nr. 07/2016,
- Rregullore Nr. 04/2016 për Inspektimin e Përmeshjes së Obligimeve Rregullatore nga Ofruesit e Licencuar të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregullore Nr.06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë.

3. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I ARRU

3.1 MISIONI DHE VIZIONI I ARRU-SË

ARRU, si autoritet i pavarur rregullator për shërbimet e ujit, ka përgjegjësi të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efçente dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë. ARRU ka të definuar misionin e saj si në vijim:

Definimi i misionit:

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikatat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme për konsumatorët në tërë Kosovën, duke pasur parasysh mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e mjedisit”.

3.2 VIZIONI

Bazuar në kornizën ligjore, ARRU përveç rregullimit të shërbimeve të ujit, ka për obligim të monitorojë që ato shërbime të ofrohen sipas standardeve. Në këtë kuptim vizioni i ARRU është definuar si:

Definimi i vizionit:

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë”.

3.3 PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ARRU-SË

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka për detyrë rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë.

Përgjegjësitë kryesore të ARRU janë përshkruar si në vijim:

- (i) Licencojë ofruesit e shërbimeve dhe të mbikëqyrë zbatimin e kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit në mënyrë që të mbrojnë interesat e konsumatorëve dhe të sigurojë që tregu të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe brenda kuadrit ligjor;
- (ii) Përcaktojë tarifatat e ofruesit të shërbimeve të ujit të pijshëm, ujërave të ndotur dhe ujit me shumicë, duke siguruar që tarifatat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;
- (iii) Vendos standardet e shërbimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve të ujit;
- (iv) Monitorojë performancën e KRU, duke i nxitur dhe inkurajuar për të ngritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë operative dhe financiare;
- (v) Zgjidhë ankesat e konsumatorëve, për të cilat konsumatori pretendon se ofruesi i shërbimit ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi;
- (vi) Inspektojë përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe zbatimin e akteve ligjore të Autoritetit;

- (vii) Hartojë dhe miratojë rregullore dhe vendime rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të Ligjit Nr. 05/L-042 dhe Ligjit Nr. 06/1 -088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/1-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

4. FUSHËVEPRIMI I ARRU

Autoriteti është themeluar në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2004/49 si Zyre Rregullore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM). Më vonë, përmes Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është transformuar në autoritet të pavarur me kompetenca dhe përgjegjësi institucionale vetëm mbi sektorin e shërbimeve të ujit.

ARRU është institucion i pavarur me përgjegjësi për rregullimin e shërbimeve të ujit në Kosovë me llogaridhënie të drejtpërdrejtë para Kuvendit të Republikës së Kosovës. ARRU mbikëqyret dhe komunikon me Kuvendin e Kosovës përmes Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.


Rregullimi i shërbimeve të ujit realizohet përmes Licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotur, të cilët operojnë në zonat e tyre përkatëse të shërbimit. ARRU ka licencuar 7 Kompani Regjionale të Ujit (KRU) dhe 1 kompani për furnizim të ujit me shumicë që është NHE Ibër-Lepenci. Ripërtëritja e licencave për këto ndërmarrje është bërë në vitin 2018 në kohëzgjatje prej 8 vitesh, në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-042 si dhe Rregulloren Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

Kompanitë e licencuara për ofrimin e shërbimeve të ujit në Kosovë janë:


- KRU Prishtina Sh. A. ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas dhe Graçanicë.
- KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Prizren (pa përfshirë 10 fshatra që furizohen nga KRU Gjakova), Malishevë, Suharekë, Dragash dhe Mamushë. Licenca e ofrimit të shërbimeve të ujit për komunën e Mamushës është e pezulluar përkohësisht, në pamundësi që KRU Hidroregjioni Jugor të sigurojë furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm.
- KRU Hidrodrini Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.
- KRU Mitrovica Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtrri. Gjatë vitit 2025 KRU Mitrovica është licencuar nga ARRU për të ofruar shërbimet edhe në 4 komunat në veri të Kosovës: Mitrovica e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok. Faturimi i konsumatorëve në këto 4 komuna do të fillojë gjatë tre-muajorit të parë të vitit 2026, sipas tarifave të përcaktuara nga ARRU.
- KRU Gjakova Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec, përfshirë 10 fshatra të komunës së Prizrenit. Bazuar në marrëveshjen midis KRU Gjakova dhe KRU Hidroregjioni Jugor për furnizim të ujit të përpunuar me shumicë, ARRU ka përcaktuar tarifën për shitjen e ujit me shumicë dhe ka iniciuar procedurat për licencim të KRU Gjakova të furnizojë ujë me shumicë për KRU Hidroregjioni Jugor.
- KRU Hidromorava Sh.A. aktualisht ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti. Komuna e Novobërdës, Parteshit, Klllokotit dhe Ranillugut janë pjesërisht të integruara nën strukturat menaxhuese të KRU Hidromorava. Gjatë këtij viti pritet të ketë progres për integrim të këtyre komunave nën umbrellën e KRU Hidromorava.
- KRU Bifurkacioni Sh.A. ofron shërbime në komunat Ferizaj dhe Kaçanik. Komuna e Hanit të Elezit është duke u menaxhuar nga KRU Bifurkacioni, megjithatë ende nuk është licencuar zyrtarisht për shkak të moskompletimit të lejeve ujore, të cilat janë kriter për aplikim për licencë pranë ARRU-së

- Ndërmarrja Hidro Ekonomike (NHE) Ibër-Lepenci Sh.A. është kompania e licencuar që ofron shërbime të ujit me shumicë, përkatësisht furnizon me ujë të papërpunuar KRU Mitrovica Sh.A. dhe KRU Prishtina Sh.A.

Në kuadër të zonës së shërbimit tek shumica e KRU-ve, e në veçanti tek KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidromorava ka një numër sistemesh rurale të cilat nuk janë të integruara në strukturën menaxhuese të KRU-ve. Kjo po ndodhë qoftë për shkak refuzimit për integrim të komunitetit, apo kundërshtimit nga ana KRU-ve, pasi gjendje teknike e sistemeve është e keqe. Fillimisht kërkohen investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë para se të mirren nën menaxhim. Në figurën 1 është prezantuar zona e shërbimit sipas KRU-ve dhe mbulueshmëria me shërbime.



Mbulueshmëria me shërbime të ujësjetës



Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit




Figura 1. Zona e shërbimit me ujë të pijshëm dhe kanalizim

4.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE E ARRU

Me qëllim të operimit efektiv, ARRU përmes Rregullores Nr. 03-0B/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit, ka të aprovuar strukturën organizative të ndarë në 4 (katër) Departamente dhe 1 (një) Njësi për Inspektim. Tri Departamentet (Departamenti për çështje ligjore dhe licencim, Departamenti i tarifave, Departamenti për raportim të performancës) dhe Njësia për inspektim realizojnë aktivitete funksionale të ARRU-së, ndërsa Departamenti i administratës dhe financave është i angazhuar në mbarëvajtjen e çështjeve të brendshme administrative, financiare dhe organizim të logjistikës. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 21, përfshirë Drejtoreshën dhe Zëvendës Drejtorin e ARRU-së. Të gjithë të punësuarit kanë profile adekuate profesionale për punët që i kryejnë.

Departamenti për çështje ligjore dhe licencim i siguron Autoritetit mbështetjen ligjore. Ky departament gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe nën-ligjore të ARRU-së bazohet në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Në kuadër të kompetencave të këtij departamenti është edhe menaxhimi i procesit të licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit, përfshirë edhe vlerësimin në baza të rregullta vjetore të përmbushjes së kushteve të licencimit dhe propozon masa për përmirësim. Në kompetencë të këtij departamenti është edhe menaxhimi ankesave të konsumatorëve, si një nga përgjegjësitë shumë të rëndësishme të Autoritetit.

Departamenti për tarifa i siguron Autoritetit mbështetjen në procesin e përcaktimit të tarifave për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit, ujërave të ndotur dhe shitjes së ujit me shumicë. Ky proces përfshinë caktimin e caqeve të cilat duhet të arrihen nga KRU-të, gjithnjë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe avancimit të sektorit si tërësi. Përmes procesit të përcaktimit të tarifave, departamenti është gjithmonë transparent me të gjitha palët e interesit, siguron gjetjen e balancës midis mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe mirëmbajtjes/ rritjes së qëndrueshmërisë financiare & operative të ofruesve të licencuar të shërbimeve. Ky departament, në baza të rregullta, harton raporte, analiza dhe vlerësime të përmbushjes së caqeve tarifore, si dhe rekomandon masa apo veprime për përmirësim të politikave dhe procesit tarifar – aty ku vlerësohet e nevojshme.

Departamenti për raportim të performancës i siguron Autoritetit mbështetjen në aktivitetin e raportimit të përmbushjes së caqeve dhe hartimit të raporteve për treguesit kyç të performancës. Ky departament bën grumbullimin dhe auditimin e saktësisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në lidhje me caqet tarifore, përpunimin e këtyre të dhënave në tregues të performancës dhe interpretimin e tyre. Departamenti harton raportet e rregullta gjashtë-mujore dhe vjetore të performancës, përmes së cilave vlerësohet gjendja dhe performanca e KRU-ve. Raportet tjera vjetore me fokus analizimin e kategorive të shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale janë pasqyrë se si po performon dhe si po zhvillohet sektori i ujit.

Departamenti i administratës dhe financave i siguron Autoritetit mbështetje administrative dhe logjistike. Ky departament mbështet Autoritetin për funksionim të përditshëm, duke menaxhuar me burimet njerëzore, buxhetin e Autoritetit, realizon aktivitetet tjera ndihmëse sa i përket inicimit të prokurimeve dhe furnizimit të mallrave & shërbimeve si dhe mirëmbajtjes së pasurisë së Autoritetit. Departamenti i administratës dhe financave është përgjegjës që në baza të rregullta vjetore të hartojë raportet financiare për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (Thesarin) dhe për Kuvendin e Kosovës. Po ashtu ky departament është përgjegjës që t'i sigurojë Autoritetit vjeljen e taksave vjetore të licencimit nga KRU-të.

Njësia për Inspektim i siguron Autoritetit mbështetjen në aktivitetin e inspektimit për përmbushjen e standardeve të shërbimit nga ofruesit e shërbimeve, për realizimin e inspektimeve tematike dhe verifikuese për standardet e shërbimeve dhe çështje të ngritura nga menaxhmenti i ARRU-së. Përmbushja e standardeve të shërbimit dhe kushteve të licencës përmbledhet në raportin vjetor që publikohet në web-faqen e ARRU-së. Edhe për inspektimet tematike dhe verifikuese që realizohen, hartohen raporte dhe vlerësime në pajtueshmëri me kornizën ligjore.

Departamentet udhëhiqen nga drejtorët e departamentit, kurse Njësia për inspektim drejtohet nga udhëheqësja e njësisë së inspektimit dhe i përgjigjen në mënyrë direkte Drejtorit dhe Zv. Drejtorit të ARRU, si persona përgjegjës për të marrë vendimet kyçe të ARRU. Struktura organizative e ARRU është prezantuar në skemën në vijim.




Figura 2. Struktura organizative e ARRU-së

4.2 BORDI I DREJTORËVE

Sipas Ligjit Nr. 05/L-042.Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit - ARRU nuk ka Bord të Drejtorëve. Sipas funksionit dhe mandatit ligjor, për tema me rëndësi për ARRU-në vendimet merren nga Drejtori i ARRU-së në këshillim të përhershëm me zëvendës drejtorin dhe menaxhmentin e mesëm.

4.3 EKZEKUTIVI I ARRU

Sipas Ligjit Nr. 05/L-042.Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU udhëhiqet nga Drejtori dhe Zëvendës Drejtori të cilët kanë përgjegjësi ligjore për administrimin dhe menaxhimin e ARRU-së, menaxhimin e financave si dhe marrjen e vendimeve në kuadër të mandatit dhe funksioneve rregullatore të Autoritetit. Përgjegjësitë specifike të drejtorit janë:

- Administrimin dhe menaxhimin e Autoritetit;
- Organizimin e procedurave dhe punësimin e personelit, aprovimin dhe nënshkrimin e rregulloreve, marrjen e vendimeve për çështjet që u përkasin funksioneve të Autoritetit;
- Menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar Autoritetit;
- Menaxhimin e buxhetit të Autoritetit, arkëtimi e taksës së licencimit dhe mënyrën e shpenzimit të financave;
- Përfaqësimin e Autoritetit brenda dhe jashtë vendit;
- Lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në pajtim me ligjet në fuqi;
- Angazhimin e ekspertëve të jashtëm me qëllim mbështetjen profesionale të Autoritetit;
- Në mungesë të Drejtorit, Autoriteti udhëhiqet nga Zëvendës Drejtori.

Drejtori i Autoritetit siguron që autoriteti të përmbush objektivat e veta në bazë të Planit Strategjik dhe Planit të Performancës ku reflektohen synimet strategjike, objektivat dhe aktivitetet përkatëse për përmbushjen e përgjegjësi të autoritetit. Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ARRU, përzgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar.

- Drejtori është zgjedhur në korrik 2021 me mandat pesë vjeçar,
- Zëvendës Drejtori është zgjedhur në nëntor 2021 me mandat pesë vjeçar.

Menaxhmenti i mesëm përbëhet nga Drejtorët e departamenteve dhe Udhëheqësi/ja e Njesisë së inspektimit dhe janë përgjegjës për organizimin dhe udhëheqjen e departamenteve/ njesisë organizative përkatëse. Ata këshillojnë drejtorin lidhur me temat specifike të njësive organizative përkatëse si dhe detyrat tjera të përcaktuara me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (Nr. 03-OB/2016) dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (Nr. 05-OB/2019).

Koordinimi dhe monitorimi i kryerjes së aktiviteteve të planifikuara në ARRU bëhet përmes takimeve të rregullta të Ekzekutivit me Menaxhmentin e mesëm. Minutat e takimit mbahen dhe ndahen me pjesëmarrësit për komente, por edhe për zbatim të punëve dhe aktiviteteve të dakorduara. Veç kësaj drejtori dhe zëvendës drejtori, sipas nevojës, organizon takime me stafin e secilit departament dhe të njesisë së inspektimit, për të ndarë informatat rreth zhvillimeve në

ARRU, por edhe për të dëgjuar rreth punës, sfidave dhe për të ndarë shqetësimet e secilit të punësuar në ARRU.

4.4 BURIMET NJERËZORE

ARRU ka të punësuar gjithsej 21 zyrtar duke përfshirë në këtë numër edhe Drejtorin dhe Zëvendës Drejtorin. Struktura profesionale e zyrtarëve është adekuate krahasuar me mandatin, fushëveprimin dhe detyrat që i ka autoriteti. Gjatë vitit 2025 ARRU ka pranuar 2 praktikante të reja, njëra në departamentin e ligjit dhe tjetra në departamentin e tarifave. Në dhjetor të viti 2025 një e punësuar, që ka mbajtur pozitën e përkthyeses, ka dalur në pension.

Në aspektin e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, për ARRU është me rëndësi që stafi të jetë i përgatitur për sfidat e vazhdueshme me të cilat përballlet sektori i shërbimeve të ujit. Është me rëndësi që ARRU si institucion të jetë atraktiv për ekspertët, që të investohet në ngritjen e kapaciteteve të personelit në fushën e rregullativës ujore.

4.5 ASETET

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë dhe Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore e bëjnë regjistrimin e aseteve përmes programit E-Pasuria, ndërsa amortizimin e aseteve vlerë fillestare mbi 1,000 Euro e bën departamenti i thesarit.

Në tabelën në vijim është dhënë lista e aseteve sipas kërkesave për raportim financiar. Vlera e përgjithshme e aseteve pas regjistrimit dhe vlerësimit për vitin 2025 është si në vijim:

Tabela 1. Vlera e aseteve në posedim të ARRU-së

Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)			
Klasifikimi pasurisë ⁱ	2024	2025	2026
Pajisjet dhe mobilet	13,912.27	8,338.26	10,584.11
Gjithësejt	13,912.27	8,338.26	10,584.11

Neni 19.3.3 Stoqet			
Klasifikimi pasurisë ⁱ	2024	2025	2026
Stoqet	6,279.42	8,766.70	7,699.87
Gjithësejt	6,279.42	8,766.70	7,699.87

ARRU aktualisht operon në objekt të ri privat i marrë me qira prej muajit prill 2025, i cili ndodhet në Prishtinë, në Rr. Gazmend Zajmi nr. 85-87. Objekti ka sipërfaqe prej 551 m². Hapësira është mjaftueshme dhe shumë e përshtatshme për punë të gjithë të punësuarve në ARRU-së. Ndërrimi i zyreve është bërë me kërkesë të pronarit të objektit paraparak, me arsyetimin se trualli ku kanë qenë zyret, është dhënë për ndërtim të lartë.

5. AKTIVITETET PËR PERIU DHËN RAPORTUESE

ARRU përmes këtij Raporti Vjetor të Punës prezanton aktivitetet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2025, aktivitete që janë zbatuar konform Planit Strategjik 2024-2026 dhe Planit të Performancës për vitin 2025. Ky raport gjithashtu do të shërbejë për të krahasuar nivelin e realizuar të aktiviteteve në vitin 2025 kundrejt planifikimeve në planin e performancës për vitin përkatës.

5.1 AKTIVITETET E REALIZUARA NË VITIN 2025

Në këtë Raport Vjetor të Punës janë listur aktivitetet sipas radhitjes së Synimeve Strategjike dhe Objektivave përkatëse në Planin Strategjik 2024-2026. Për të lehtësuar krahasimin dhe matjen e rezultateve të arritura, për secilin aktivitet të propozuar në Planin e Performancës për vitin 2025, është dhënë përshkrimi i nivelit të përmbushjes, përfshirë edhe treguesit e matjes; e në rastin e mos përmbushjes është dhënë sqarim përshkrues për arsyet e mos-përmbushjes.

Synimi Strategjik 1: Korniza ligjore dhe rregullative është në përkrahje të zhvillimit të qëndrueshëm të ofruesve të shërbimeve dhe e balancuar me kërkesat e konsumatorëve

ARRU, bazuar në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ligjit Nr. 06/L-088 për Ndryshimin dhe Plotësimin e tij, është institucioni kyç për rregullimin e sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë. Autoriteti po ashtu, përmes Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim, ka përgjegjësinë për të hartuar dhe miratuar rregullore, standarde dhe vendime rregullatore që mbështesin ofruesit e shërbimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe që sigurojnë mbrojtjen e konsumatorëve.

Korniza ligjore dhe rregullatore kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit: Gjatë vitit 2025 janë hartuar 3 rregullore dhe 11 vendime rregullatore që kryesisht kanë pasur të bëjnë me ndryshimet në metodologjinë tarifore.

- 1) Rregullorja (ARRU) Nr. 02/2025 për Menaxhimin dhe Administrimin e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit, e cila përbën bazën institucionale për funksionimin, organizimin dhe qeverisjen e brendshme të Autoritetit.
- 2) Ndryshim-plotësimi i Rregullores Nr. 15/2025 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve. Plotësim/ ndryshimi i kësaj rregullore është bërë me qëllim të saktësisht të natyrës së ankesave të konsumatorëve të cilat shqyrtohen nga ARRU, përkatësisht është definuar qartë se ARRU nuk është institucion që merret me parashkrimin (shlyerjen) e borgjeve të vjetra të konsumatorëve. Kjo kategori e ankesave është përgjegjësi e institucioneve përkatëse gjyqësore.
- 3) Draft-Rregullorja Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve në Kosovë. Me këtë rregullore janë përcaktuar procedurat, kriteret e licencimit dhe kushtet e licencës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Republikën e Kosovës. Përmes kësaj rregullore krijohet një sistem i hapur, transparent dhe i barabartë për dhënie, përfitjen dhe vazhdimin e licencave për shërbimet e ujit.

Monitorimi dhe zbatimi i politikave ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve: Monitorimi i ofruesve të shërbimeve është një instrument kyç për vlerësimin dhe përmirësimin e performancës. Gjatë vitit 2025 janë realizuar takime dhe vizita tek ofruesit e shërbimeve, me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike në aspektin e përmbushjes së kushteve të licencës. Këto takime kanë pasur në rend dite dy çështje: Progresi për nënshkrimin e kontratave me konsumatorët dhe Trajtimin e ankesave të konsumatorëve. Të dy këto tema janë diskutuar me

7 ofruesit e shërbimeve dhe janë elaboruar mënyrat e arritjes së progresit më të shpejtë në të dy këto çështje.

Departamenti për Çështje Ligjore dhe Licencim ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me ofruesit e licencuar për të monitoruar ndryshimet që ndodhin në organizatat e tyre dhe për të siguruar që çdo ndryshim të reflektohet në dosjet e licencimit, siç janë: zgjerimi i zones së shërbimit, progresi në marrjen e lejeve ujore dhe lejeve për shkarkim të ujërave të ndotur, etj.

Zgjidhja e ankesave të konsumatorëve: Komisioni për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve është një organ i pavarur dhe profesional që ka si qëllim shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve lidhur me shërbimet e ujit, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent që mbron të drejtat e konsumatorëve, garanton llogaridhënien e ofruesve të shërbimit të ujit dhe siguron trajtim të barabartë për të gjithë konsumatorët. Komisioni mbanë evidenca dhe regjistra për trajtimin e çdo ankese që parashtrohet në ARRU.

Komisioni ka pranuar gjithsej 460 ankesa, në tabelën 2 janë paraqitur ankesat sipas KRU-ve përgjatë muajve të vitit 2025.

Tabela 2. Numri i Ankesave të Parashtruara nga Konsumatorët sipas Rajoneve

Rajoni	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
KRU Prishtina	36	45	71	21	41	32	21	17	23	19	19	18	363
KRU Mitrovica	0	0	0	1	1	2	0	0	2	0	0	1	7
KRU Hidrodrini	1	2	1	1	0	0	2	0	0	0	0	0	7
KRU Gjakova	1	3	3	0	0	0	5	1	1	5	4	2	25
KRU Hidro. Jugor	2	2	1	0	2	1	0	1	1	2	0	6	18
KRU Bifurkacioni	5	1	5	2	1	1	2	0	2	4	2	3	28
KRU Hidromorava	2	1	1	2	2	0	0	1	1	0	1	1	12
Gjithsej	47	54	82	27	47	36	30	20	30	30	26	31	460

Ankesat e parashtruara nga konsumatorët kryesisht përfshijnë çështje të lidhura me kontestimin e borxhit, të mënyrës së faturimit dhe mos leximin e ujëmatësit. Konsumatorët kërkojnë rishikimin e borxhit të tyre dhe, në disa raste, anulimin e tij për shkak të parashkrimit. Ankesa të tjera lidhen me mos përputhjen midis konsumit të faturuar dhe atij të regjistruar nga ujëmatësi, si dhe me faturimin paushall dhe fiktiv, i cili nuk është i bazuar në konsum të matur, ashtu siç e parasheh korniza ligjore dhe rregullatore. Sipas natyrës, ankesat janë kategorizuar si në tabelën 3:

Tabela 3: Natyra e ankesave të konsumatorëve

Rajoni	Kontestim i faturimit	Kontestim borxhi/ Parashkrim borxhi	Faturim paushall	Moslexim i rregullt i ujëmatësit	Të tjera	Gjithsej
KRU Prishtina	120	186	27	7	23	363
KRU Mitrovica	4	3	0	0	0	7
KRU Hidrodrini	3	3	1	0	0	7
KRU Gjakova	14	8	0	1	2	25
KRU Hidro. Jugor	10	8	0	0	0	18
KRU Bifurkacioni	17	10	0	0	1	28
KRU Hidromorava	5	6	0	0	1	12
Gjithsej	173	224	28	8	27	460

Komisioni për zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve ka mbajtur 99 takime për shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi ankesat e pranuar. Gjatë vitit 2025 komisioni ka pranuar gjithsej 460 ankesa. Prej tyre, 382 ankesa janë zgjidhur gjatë këtij viti, si dhe janë zgjidhur edhe 206 ankesa të bartura nga viti 2024. Në total, gjatë vitit 2025, komisioni ka trajtuar dhe zgjidhur gjithsej 588 ankesa. Në fund të vitit 2025, kanë mbetur për shqyrtim gjithsej 78 ankesa, të cilat janë bartur për trajtim në vitin 2026.

Komisioni ka vendosur mbi ankesat e zgjidhura në mënyrë të organizuar dhe sipas kategorive të shqyrtimit. Nga totali i ankesave të shqyrtuara (gjithsej 588), 38 ankesa janë aprovuar plotësisht, 32 ankesa janë aprovuar pjesërisht, 102 ankesa janë refuzuar, ndërsa 148 ankesa janë kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje. Sa i përket ankesave që nuk kanë përmbushur kushtet ligjore për shqyrtim të mëtjshëm, Komisioni ka vepruar në përputhje me procedurat e përcaktuara ligjore: për 25 ankesa është nxjerrë njoftim për palën duke e udhëzuar për veprimet e mëtjshme, për 90 ankesa Komisioni ka shpallur veten jo kompetent për shqyrtimin, për 95 ankesa janë dhënë vendime duke i hedhur poshtë si të palejuara, ndërsa 22 ankesa janë hedhur poshtë si të parashtruara pas afatit për shkak të dorëzimit jashtë afateve ligjore. Gjithashtu, për 20 ankesa Komisioni ka urdhëruar KRU-në të nxjerrë vendim, dhe 1 ankesë është kthyer për rishqyrtim nga Gjykata e Themelore Prishtinë. Për procedurat e veçanta, 7 ankesa janë përfunduar me kërkesë të konsumatorit, për 2 ankesa është lëshuar akt-përcjellës, 3 ankesa janë tërhequr nga palët, 1 ankesë është drejtuar gabimisht në ARRU, 1 kërkesë i është drejtuar palës për plotësim lënde, dhe 1 ankesë është anuluar pasi ishte protokolluar dy herë dhe ishte e njëjtë me ankesën e pranuar paraprakisht.

Rezultatet e rasteve gjyqësore që kanë përfshirë ARRU-në gjatë vitit 2025, të kategorizuara sipas llojit të vendimit dhe nivelit gjyqësor përkatës.

Tabela 4: Rastet e involvimit të ARRU-së në procese gjyqësore

Kategoria e rezultatit	Gjykata Themelore	Gjykata Komerciale	Gjykata e Apelit	Gjykata Supreme	Gjithsej
Raste në proces gjyqësor	17	0	0	0	17
Raste të refuzuara për palët e jashtme	22	1	5	2	30
Raste të aprovuara (parashkrim), për palët e jashtme	6	0	0	0	6
Padi të tërhequra nga palët e jashtme	3	0	0	0	3
Raste të hedhura poshtë / të palejuara, për palët e jashtme	3	0	0	0	3
Raste të transferuara (juridiksioni)	1	0	0	0	1
Raste të shpallura jokompetente, për palët e jashtme	1	0	0	0	1
Raste me procedurë të pezulluar, për palët e jashtme	1	0	0	0	1
Pjesëmarrje ne seanca gjyqësore	44	0	2		46
Numri i lëndëve dhe i përgjigjeve në padi të përgatitura për Gjykatën Themelore	20	0	0	0	20
Padi të parashtruara nga ARRU	0	1	0	0	1
Padi të parashtruara nga palët e jashtme	20	0	0	0	20
Ankesa të parashtruara nga ARRU në Gjykata të shkallës së dytë	0	0	3	0	3
Ankesa të parashtruara nga palët e jashtme, në Gjykata të shkallës së dytë	0	0	9	0	9

Më qëllim që vendimet të jenë sa më të drejta dhe të bazuara në ligj, Komisioni ka realizuar vizita për verifikimin e gjendjes faktike në terren. Në këto vizita gjithmonë kanë qenë prezent edhe palët në kontest nga ofruesi i shërbimeve dhe pala ankuese. Duhet theksuar se procesverbalet e hartuara gjatë këtyre vizitave kanë ndihmuar Komisionin për shqyrtimin dhe vendim marrjen meritorë të ankesave.

Komisioni ka organizuar edhe seanca dëgjimore publike për rastet ku ka qenë e nevojshme dëgjimi i palëve në kontest. Për secilën seancë është hartuar procesverbal, duke siguruar transparencë dhe dokumentim të saktë të procedurës.

Në tabelën 5 është prezantuar krahasimi midis aktiviteteve të planifikuara në Planin e Performancës (2025) dhe të aktiviteteve të realizuara në kuadër të Synimit Strategjik 1. Po ashtu janë dhënë sqarime plotësuese në rast të mos-përmbushjes së aktiviteteve të planifikuara.

Tabela 5. Aktivitetet e realizuara sipas objektivave në kuadër të synimit strategjik 1

#	Aktiviteti	Statusi i përbushjes
Objektiva 1: Korniza ligjore dhe rregullatore kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit		
1.1	Dhënia e komenteve shtesë dhe kontributit në finalizimin e Ligjit për Autoritetin Rregullator dhe Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i cili është dërguar tek Komisioni Parlamentar	<p>Nuk është realizuar</p> <p>ARRU ka hartuar draftin e parë të Ligjit për Autoritetin Rregullator dhe për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe e ka dorëzuar tek Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në muajin maj të vitit 2022 dhe ka bërë arsyetimet për ndryshimet që janë propozuar.</p> <p>Komisioni Palramentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ende nuk e ka vendosur për të proceduar draft ligjin për diskutim me palët e interesit.</p>
1.2	Rishikimin e legjislacionit në fushën e rregullimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit të ujit me qëllim të ngritjes të standardeve të shërbimit dhe përafrimit me legjislacionin Evropian	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU ka rishikuar kornizën ligjore sekondare.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <p>Janë plotësuar dhe ndryshuar tri (3) Rregullore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja (ARRU) Nr. 02/2025 për Menaxhimin dhe Administrimin e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit - Ndryshim-plotësimi i Rregullores Nr. 15/2025 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve, - Rregullorja Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve në Kosovë.
1.3	Mbajtja e punëtorive dhe takimeve të rregullta me KRU-të me qëllim të monitorimit të harmonizimit të akteve normative të KRU-ve me kornizën ligjore / rregullatore të ARRU-së dhe zhvillimi i procedurave për trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe nxjerrja e vendimeve në mënyrë meritore	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU ka mbështetur ofruesit e shërbimeve në hartimin, vlerësimin dhe interpretimin e ligjshmërisë së akteve normative të brendshme të ofruesve të shërbimeve.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë vitit 2025 janë mbajtur takime individuale me 7 KRU-të ku temë diskutimi ka qenë nënshkrimi i kontratave të shërbimit me konsumatorët. - Kërkesa për takime dhe agjenda e takimit.
1.4	Hartimi i shkresave zyrtare, vendimeve rregullatore dhe shkresave të tjera të ARRU-së, të cilat duhet të kalojnë përmes departamentit të ligjit për t'u siguruar që dokumentet zyrtare janë në përputhje me legjislacionin në fuqi	<p>Është realizuar</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ARRU ka hartuar 11 vendime rregullatore dhe ka mbështetur ofruesit e shërbimeve në hartimin e dokumenteve
Objektiva 2: Monitorimi dhe zbatimi i politikave ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve		

2.1	<p>Monitorimi dhe inspektimi i rregullsisë së punës së KZAK të shkallës së parë, për pranimin, zgjidhjen dhe vendimmarrjen për ankesa të konsumatorëve</p>	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU me vëmendje monitoron KZAK shkalla e parë (në nivel të KRU-ve) si niveli i parë i trajtimit të ankesave të konsumatorëve të procedurës administrative.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ARRU ka mbajtur takime dhe ka dërguar shkresë zyrtare tek KRU-të (menaxhmenti i KRU-ve dhe janë kopjuar kryesuesit e Bordeve të Drejtorëve dhe NjPMNP) me kërkesë të rritet efikasiteti i KZAK shkalla e parë.
2.2/ 2.3 dhe 2.4	<p>- Takimet e rregullta, organizimi i vizitave në teren dhe seancave dëgjimore sipas nevojës të KZAK, lidhur me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për ankesat e konsumatorëve</p> <p>- Bashkëpunim i ngushtë me ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorët, lidhur me kompletimin e lëndëve për trajtimin e ankesat e parashtruara në KZAK shkalla e dytë</p> <p>- Udhëheqja me seancat dëgjimore të Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave - KZA (shkalla e dytë) për shqyrtimin dhe vendimmarrjen për ankesat e konsumatorëve</p>	<p>Është realizuar.</p> <p>ARRU i kushton rëndësi të madhe trajtimit profesional të ankesave të konsumatorëve.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ARRU ka pranuar gjithësejt 460 ankesa në vitin 2025. - ARRU ka shqyrtuar dhe zgjidhur 588 ankesa në vitin 2025, 206 ankesa të bartura nga viti 2024 dhe 382 ankesa të pranuar në vitin 2025 (gjithësej 588 ankesa).
2.5	<p>Përgatitja e parashtrësive të lëndëve dhe pjesëmarrja në seancat gjyqësore sipas kërkesës së Gjykatës në përgjigje të ankesave të konsumatorëve apo ofruesve të shërbimeve</p>	<p>Është realizuar.</p> <p>ARRU i kushton rëndësi të madhe trajtimit profesional të ankesave të konsumatorëve.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për secilën ankesë të parashtruar, ARRU kërkon të dhëna shtesë nga KRU-të për të plotësuar dosjen dhe për të qenë në gjendje të marrjes së vendimit merititor. - Pjesëmarrje ne seanca gjyqësore 44 - Numri i lëndëve dhe i përgjigjeve në padi të përgatitura për Gjykatën Themelore
2.6	<p>Takime në Ministrinë e Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë (MTIN) - Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Këshillin për Mbrojtje të Konsumatorit dhe palët e interesit</p>	<p>Është realizuar.</p> <p>ARRU merr pjesë aktive dhe kontribuon në Këshillin për mbrojtje të konsumatorëve që funksionon në kuadër të MTIN.</p> <p>Treguesit e matjes:</p>

		<ul style="list-style-type: none"> - ARRU ka marrë pjesë në takime të këshillit për mbrojtje të drejtave të konsumatorëve në MTIN. - Këshilli për mbrojtje të drejtave të konsumatorëve ka qenë i ftuar në takimet / diskutimet publike ku është diskutuar për procesin tarifor 2026-2028.
2.7	Monitorimi i nënshkrimit të kontratave në mes të konsumatorit dhe KRU-ve dhe kontratave për shërbime midis komunave dhe KRU-ve	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU ka monitoruar në vazhdimësi progresin e arritur lidhur me nënshkrimin e kontratave të shërbimit midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimit.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Realizimi i takimeve me 7 KRU-të me qëllim të shtytjes për të arritur progres për nënshkrim të kontratave me konsumatorët. - Pas kërkesave dhe presionit të ARRU-së, KRU-të kanë bërë progres të mirë të nënshkrimit të kontratave me konsumatorë. - Po ashtu është kërkuar që KRU-të të përditësojnë kontratat e shërbimit me komuna; për momentin të gjitha KRU-të kanë të nënshkruara kontrata me komunat përkatëse për zonat të cilat menaxhohen nga KRU-të.
2.8	Mbështetje për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese për konsumatorët duke përdorur mjetet e komunikimit për sensibilizim dhe njoftim të konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU publikon në vazhdimësi të gjitha informatat dhe lajmet në lidhje me shërbimet e ujit.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lajmet/ njoftimet publikohen në ueb-faqe të ARRU.
2.9	Hulumtimi i opinionit të konsumatorëve lidhur me kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara nga KRU-ut	<p>Nuk është realizuar</p> <p>ARRU në vitin 2025 nuk ka realizuar hulumtim të opinionit publik në mungesë të stafit dhe tej-ngarkesës me punë rreth shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve dhe zhvillimit të metodologjisë tarifore.</p>
Objektiva 3: Monitorimi i zbatimit të kushteve të licencës të ofruesve të shërbimeve të ujit		
3.1	Monitorimi i ofruesve të shërbimeve lidhur me përtëritjen e lejeve ujore të cilat afatin e skadencës e kanë në vitin 2023	<p>Ka pasur takime, por nuk ka pasur rezultate</p> <p>Menaxhmenti i ARRU ka ngritur shqetësime lidhur me mos pajisjen e ofruesve të shërbimeve me leje ujore për shfrytëzimin e burimeve të ujit.</p> <p>Që nga shtatori/tetori i vitit 2023 asnjëra prej 7 KRU-ve nuk ka leje për shfrytëzim të asnjërit prej burimeve të ujit. Rrjedhimisht, mos pajisja apo skadencia e lejeve ujore do duhej të nxiste ARRU-në të pezullonte licencën e shërbimit.</p> <p>Të gjitha KRU-të kanë sqaruar se nuk kanë kapacitete profesionale për të hartuar elaborate për shfrytëzim të burimeve të ujit të nivelit çfarë kërkohen me Udhëzimin</p>

		<p>Administrativ në fuqi për pajisje me leje ujore. Në anën tjetër MMPHI-ARPL kërkon me ngulm që aplikacionet e KRU-ve për leje ujore duhet të përmbushin strikt kërkesat e Udhëzimit Administrativ në fuqi.</p> <p>ARRU sheh si tejet problematike çështjen e lëshimit të lejeve ujore dhe lejeve për shkarkim të ujërave të ndotur, pasi në vitin 2026 do të kemi proces të rregullt të licencimit të KRU-ve, dhe njëri nga dokumentet kryesore që kërkohet për licencim është pajisja me Leje Ujore.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ARRU ka pasur takime me të gjithë kryeshefat ekzekutiv dhe kryesuesit e bordeve të drejtorëve të KRU-ve, ka pasur 2 takime me zëvendës-ministrat e MeE dhe të MMPHI dhe 1 takim me drejtorin e Autoritetit Rajoonal të Pelgjeve Lumore (ARPL) për gjetje të zgjidhjes dhe tejkalim të kësaj situatë. - Deri në fund të vitit 2025 asnjë rezultat nuk është arritur në këtë drejtim.
3.2	<p>Monitorimi i përmbushjes së kushteve të licencës nga ofruesit e shërbimeve të ujit, përmes vlerësimeve të rregullta dhe identifikimit të fushave që kërkojnë përmirësime, në përputhje me kushtet e licencës</p>	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU realizon inspektime dhe auditim të rregullt vjetor të gjitha operimeve të KRU-ve. Atëherë kur vërehet ndonjë çështje që cenën kushtet e licencës, ARRU reagon përmes paralajmërimit tek KRU duke kërkuar informata shtesë dhe korrigjim të veprimeve, nëse ka pasur shkelje.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkresë për të gjithë Kryeshefat Ekzekutiv të KRU-ve për skadimin e lejeve ujore dhe nevojës për të bërë progres në këtë çështje. - Takimet me zyrtarët dhe personat përgjegjës të MeE dhe MMPHI për të diskutuar për çështjen e lejeve ujore dhe nevojën e gjetjes së zgjidhjes. - Mbështjettja e KRU Mitrovica për licencim të zgjerimit të zonës së shërbimit gjatë integritimit të 4 komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviç. - Paralajmërimi për KRU-të për mos përmbushje të standardeve të shërbimit.
3.3	<p>Hartimi i raportit rreth përputhshmërisë me kushtet e licencës</p>	<p>Nuk është realizuar</p> <p>Përputhshmëria me kushtet e licencës është përfshirë në Raportin e Përmbushjes së Nivelit të Standardeve të Shërbimit.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për shkak të angazhimit institucional në zhvillimin dhe implementimin e Sistemit Informativ të Shërbimeve të Ujit (SISHU), si dhe kufizimeve në kapacitetet

		njerëzore, nuk është hartuar raporti narrativ për përmbushjen e standardeve të shërbimit për vitin 2024, në kuadër të të cilit zakonisht përfshihet edhe vlerësimi i përputhshmërisë me kushtet e licencës.
3.4	Monitorimi i ofrimit të shërbimeve të ujit nga KRU “Hidroregjioni Jugor” për Komunën e Mamushës dhe vendimi i ARRU-së për pezullimin e përkohshëm të licencës	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU ka qenë në komunikim me KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Gjakova dhe MeE në lidhje me zgjidhjen e problemit për furnizim me ujë të komunës së Mamushës.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i takimeve me ftesë të ARRU me palët e sipër përmendura me qëllim ofrimin e zgjidhjeve ligjore që KRU Gjakova të shesë ujin e përpunuar me shumicë për KRU Hidroregjioni Jugor dhe ndarja e përgjegjësisë të secilës palë që hyn në marrëveshje për shit-blerje të ujit me shumicë.
3.5	Mirëmbajtja dhe përditësimi i databazës me të dhëna për ofruesit e shërbimeve të licencuar dhe për zonën e shërbimit, të sigurohet që informacionet janë të sakta dhe të besueshme	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU mirëmban dhe përditëson të dhënat për ofruesit e shërbimeve të licencuar për zonën e shërbimit dhe për kushtet e licencës.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i sistemit të fajlimit dhe ruajtja e të dhënave në regjistrator.

Synimi Strategjik 2: Menaxhimi dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e infrastrukturës së shërbimeve të ujit sigurohet përmes procesit tarifor

ARRU ka përgjegjësinë ligjore të përcaktimit të tarifave dhe përcjelljen/ monitorimin e përbushjes së caqeve tarifore të cilat janë aprovuar në ciklin paraprak tarifor (2025). Këto përgjegjësi realizohen përmes departamentit të tarifave. Aktivitetet kryesore të cilat janë kryer gjatë vitit 2025 nga menaxhmenti dhe nga departamenti i tarifave, për përbushje të këtij synimi strategjik, janë elaboruar në tekstin në vijim:

Mbështetja e ofruesve të shërbimit për hartimin e planeve strategjike: ARRU edhe gjatë vitit 2025 ka mbështetur po edhe ka bërë shtytje tek KRU-të për hartimin e planeve strategjike siç janë: Plani i Biznesit dhe Plani i Menaxhimit të Thatësisë. Plani i Investimeve Strategjike dhe Plani për Reagim në Situata Emergjente, të cilat janë ligjërish obligative, është dakorduar të hartohen gjatë vitit 2026.

Gjatë vitit 2025 ARRU në bashkëpunim të ngushtë me KRU-të kanë punuar në hartimin e Biznes Planit Rregullator që ka shërbyer për aplikim tarifor për vitet 2026-2028.

Për sa i përket Planit të Menaxhimit të Thatësisë, ky projekt me mbështetje të Programit të USAID - Kosovo Adapt Activity dhe që implementohej nga Tetra Tech, i filluar në vitin 2024 dhe që pritej të përfundohej në vitin 2025, ishte anuluar sipas vendimit të presidentit të SHBA-së për ndërprerje të gjitha projekteve të USAID. Puna e mirë e filluar në hartimin e metodologjisë dhe të planeve tani ka ngecur. ARRU është në kërkim të donatori për vazhdim të financimit.

Rishikimi madhor i metodologjisë tarifore: Në vitin 2025 ARRU, me mbështetje të konsulentit ndërkombëtar dhe bashkëpunimit me KRU-të, ka finalizuar ndryshimet në politikat tarifore, procedurat e përcaktimit të tarifave, ka zhvilluar dhe testuar metodologjinë e re tarifore (modelin tarifor në Excel). Trajnimet e stafit kyç të KRU-ve dhe i ARRU-së për përdorim të aplikacionit të metodologjisë është realizuar. Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) ka mbështetur financiarisht konsulentin ndërkombëtar që ka zhvilluar modulën tarifor.

Ndryshimet e propozuara konsistojnë me sa vijon:

- Heqja graduale e ndër-subvencionimit midis konsumatorëve jo shtëpiak dhe shtëpiak;
- Kompensimi ndaj konsumatorëve për investimet kapitale të planifikuara (të përfshira në tarifa) dhe që nuk janë realizar;
- Përmirësimi i efikasitetit komercial përmes reduktimit realist, por sfidues, të humbjeve komerciale (aparente) të ujit;
- Aplikimi i tarifave fikse mujore të bazuara në madhësinë e lidhjes (apo ujëmatësit) dhe përcaktimi i tarifës fikse mujore për konsumatorët që marrin vetëm shërbime të ujërave të ndotur;
- Aplikimi i ngarkesës sipas vëllimit të vlerësuar të ujërave të ndotura të shkarkuara në rrjet dhe jo bazuar në volumin e ujit të pijshëm (për konsumatorët që kanë burime alternative të ujit) dhe konsumatorët që marrin vetëm shërbime të ujërave të ndotur;
- Aplikimi i tarifave për mbingarkesë (zhvillim) të infrastrukturës;
- Ndryshimi/ rritja e vlerës së koeficientit të kthimit në bazën rregullatore të aseteve (BRRA) dhe rishikimi i bazës rregullatore të aseteve për KRU Mitrovica, KRU Hidromorava dhe KRU Bifurkacioni për shkak të integritetit (të planifikuar) të komunave të reja në zonën e shërbimit;

- Aplikimi i tarifave për efluentët që shkarkohen nga bizneset dhe industria, për t'u siguruar që konsumatorët me ndotje më të madhe të ujërave të ndotur të paguajnë më shumë për koston e trajtimit të ujërave të ndotur;
- Aplikimi i bonuseve/ nxitja për përmirësim për ofruesit e shërbimeve që dorëzojnë plane kualitative të biznesit;
- Përcaktimi i tarifave 2026 – 2028, mbajtja e parave kesh dhe pritshmëritë për investime.

Të gjitha ndryshimet e propozuara janë reflektuar dhe përfshirë në modulën e zhvilluar tarifor që do të aplikohet për ciklin tarifor tre-vjeçar për periudhën 2026-2028. Po ashtu të gjitha këto parime janë integruar në dokumentet për politika tarifore, në procedurat e përcaktimit tarifor, përfshirë këtu hartimin e udhëzuesit për përdorim të modulit tarifor. Ndryshimet e sipërme duhet të reflektohen edhe në Rregulloren për përcaktimin e tarifave për shërbimet e ujit, që planifikohet të ndryshohet-plotësohet gjatë vitit 2026.

Realizimi i procesit tarifor për periudhën 2026-2028: krahas zhvillimit të metodologjisë tarifore ARRU, gjatë vitit 2025, ka punuar edhe në përcaktimin e tarifave për shërbimet e ujit për periudhën 2026-2028.

Pra, gjatë vitit 2025 departamenti i tarifave ka koordinuar aktivitetet me të gjitha KRU-të dhe me NHE Ibër Lepenci për aplikim tarifor për ciklin tarifor 2026-2028. Për më shumë, departamenti i tarifave ka mbështetur KRU-të në përgatitjen e propozimeve tarifore dhe finalizimin e Biznes Planit Rregullator, që ka shërbyer si bazë për përcaktimin e tarifave për shërbimet e ujërave dhe për furnizim të ujit me shumicë (të papërpunuar dhe të përpunuar). Duhet theksuar se këtë vit, për shkak të marrëveshjes midis KRU Gjakova dhe KRU Hidroregjioni Jugor për shitje / blerje të ujit me shumicë për të furnizuar komunën e Mamushës, ARRU është marrë me përcaktimin e tarifave për ujin me shumicë për KRU Gjakova. Krahas kësaj, stafi i ARRU-së është marrë edhe me përgatitjen dhe realizimin e debateve publike në të 7 regjionet ku janë propozuar kërkesat e secilës KRU për tarifën e shërbimeve të ujit. Urdhërsa tarifore për ciklin tarifor 2026-2028 iu është dërguar të gjithë ofruesve të shërbimeve më 31 dhjetor 2025.

Për dallim nga vitet e kaluara, në këtë cikël tarifor (2026-2028) ka pasur një ngritje të ndieshme të tarifave të shërbimeve të ujit krahasuar me vitet paraprake. Megjithatë tarifën e shërbimeve të ujit në Kosovë mbeten ende nga më të ulëtat në Europë, dhe që nuk rëndojnë gjendjen financiare të ekonomive familjare. Për një familje mesatare në Kosovë që hargjon mesatarisht 10 m³ ujë në muaj lartësia mesatare e faturës për shërbimet e ujit është 8.8 euro/muaj. Edhe përkundër sfidimeve dhe kërkesave për rritje të efijencës së KRU-ve, ARRU nuk ka mundur ti ikë ngritjes së tarifave, të cilat kryesisht janë ngritur si pasojë e faktorëve vijues:

- Rritja enorme e koston së energjisë elektrike, si pasojë e detyrimit të KRU-ve, sikur edhe e bizneseve të tjera, për dalje në tregun e lirë të energjisë. Faturat e energjisë elektrike nga muaji qershor-dhjetor 2025 për KRU-të janë rritur mesatarisht 150% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, para daljes në tregun e lirë të energjisë.
- Futja në funksion e impianteve të përpunimit të ujërave të ndotur në disa regjione, përkatësisht planifikimi që së shpejti të hyjnë në operim këto impiante në regjionet të tjera, ka ndikuar po ashtu në rritjen e tarifave për shërbimet e ujit.
- Rritja e investimeve vetanake të KRU-ve për ripërtëritje dhe mirëmbajtje të infrastrukturës së ujit dhe ujërave të ndotur. ARRU ka parasysh se gjendja aktuale e infrastrukturës është jo

e mirë, që karakterizohet me humbje të larta të ujit dhe efijencës të ulët të shfrytëzimit të burimeve të ujit.

Monitorimi i përmbushjes së caqeve tarifore dhe auditimi i investimeve kapitale për periudhën 2024/2025 dhe përcaktimi i caqeve 2026-2028: departamenti i tarifave gjatë vitit 2025 është marrë me monitorimin e përmbushjes së caqeve tarifore dhe të investimeve kapitale për vitin 2024. Lidhur me këto procese janë hartuar raportet “Raporti vjetor i realizimit të caqeve të vitit 2024” dhe “Auditimi i investimeve kapitale të vitit 2023”. ARRU ka vërejtur si të kënaqshëm trendin në rritje në përmbushjen e caqeve tarifore dhe të investimeve kapitale gjatë ciklit tarifor 2022-2024 dhe gjatë vitit 2025.

Në tabelën 6 janë listuar aktivitetet e planifikuara në Planin e Performancës (2025) dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të Synimit Strategjik 2. Po ashtu janë dhënë sqarime plotësuese në rast të mos-përmbushjes së aktiviteve të planifikuara.

Tabela 6. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të Synimit Strategjik 2

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
Objektivi 1: Planet strategjike të ofruesve të shërbimeve janë rishikuar dhe aprovuar nga ARRU		
1.1 dhe 1.2	Planet e Biznesit (PB) janë hartuar nga KRU-të për vitin 2026 dhe janë harmonizuar me Planet e Biznesit Rregullator (PBRR); PB janë aprovuar nga ana e ARRU Planet e Menaxhimit të Aseteve (PMA) janë hartuar nga KRU-të dhe janë harmonizuar me PB dhe PBRR; PMA janë aprovuar nga ana e ARRU.	Është realizuar pjesërisht Të dyja këto plane janë hartuar dhe janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara. Treguesit e matjes: - Plani i Biznesit është hartuar nga të gjitha KRU-të dhe është harmonizuar në masë të konsiderueshme me Planin e Biznesit Rregullator. Për shkak të procesit tarifor 2026-2028, caqet dhe treguesit e performancës janë unifikuar. - Është bërë përparimi i kënaqshëm në përditësimin e Planeve të Menaxhimit të Aseteve, e veçanërisht përparim i ndieshëm është bërë në digjitalizimin e infrastrukturës së ujit dhe paraqitjes së tyre në GIS.
1.3 dhe 1.4	ARRU ka hartuar metodologjinë / udhëzuesin për Planet e Menaxhimit të Thatësisë Planet e Menaxhimit të Thatësisë janë hartuar nga KRU-të sipas udhëzuesit të ARRU-së; PMTh janë aprovuar nga ana e ARRU-së Mbështetja e KRU-ve për hartimin e Planit të Investime Kapitale	Projekti ishte pezulluar nga USAID ARRU (në koordinim me USAID) është pajtuar që Plani i Menaxhimit të Thatësisë (PMTh) të zhvillohet në dy faza. Në fazën e parë ishte dakorduar të hartohet Udhëzuesi lidhur me formatin dhe përmbajtjen e PMTh, definimin e qartë të kriterëve për aprovim dhe monitorim të zbatimit të PMTh. E në fazën e dytë është dakorduar të mbështeten dy KRU për të hartuar PMTh. Projekti i sipër-përmendur kishte filluar në tre-mujorin e fundit të vitit 2024 dhe ishte draftuar një draft i parë i Metodologjisë, por që kishte nevojë për plotësime dhe ndryshime.

	<p>Afatgjata (PIK), vënia e afatit për dorëzim të dokumentit final.</p> <p>Sqarim:</p> <p>Projekti i USAID - Kosovo Adapt Activity kishte shprehur interes për të mbështetur ARRU-në dhe KRU-të për hartimin e Udhëzuesit dhe Planeve të Menaxhimit të Thatësisë.</p>	<p>Në ndërkohë, në fillim të vitit 2025, sikur që ndodhi me të gjitha investimet e USAID, mbështetja financiare edhe për këtë projekt ishte pezulluar në fazë shumë të hershme.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punëtori me pjesëmarrje të KRU-ve dhe të MeE për të elaboruar qëllimin, objektivin dhe afatet kohore për zbatim të projektit, - Drafti i parë i udhëzuesit është hartuar dhe dorëzuar për komente tek ARRU në mes të dhjetorit 2024, - ARRU kishte përgatitur komentet në Metodologjinë e draftuar dhe kishte dorëzuar konsulentit. - Në fillim të marsit 2025 ARRU edhe zyrtarisht informohet se projekti mbështetës është pezulluar.
<p>Objektiva 2: Tarifat e shërbimeve të ujit mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm të aseteve të ofruesve të shërbimeve dhe janë të përballueshme për konsumatorët</p>		
<p>2.1</p>	<p>Shkresat me ndryshimet e propozuara të metodologjisë dhe politikave tarifore janë dakorduar brenda ARRU-se dhe janë ndarë me KRU-të.</p>	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU, me mbështetje të konsulentit, ka hartuar 11 shkresa – në formë vendimesh – ku janë propozuar ndryshimet e metodologjisë tarifore.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkresat janë finalizuar, protokolluar dhe ndarë me KRU-të dhe palët tjera të interesit, - Komentet nga palët e interesit janë pranuar dhe janë përfshirë, për aq sa ka qenë e arsyeshme.
<p>2.2</p>	<p>Metodologjia tarifore dhe modulet për përcaktimin e tarifave janë përshtatur me kërkesat dhe ndryshimet e propozuara, i njëjti është testuar dhe janë kryer trajnime përkatëse për stafin e ARRU-së dhe të KRU-ve</p>	<p>Është realizuar</p> <p>Metodologjia e përmirësuar tarifore, përfshirë të gjitha modulet, për përcaktimin e tarifave është zhvilluar dhe është testuar. Versioni final është ndarë me KRU-të për komente dhe për rishikim.</p> <p>Përveç kësaj, 2 cikle trajnime për stafin e KRU-ve janë organizuar, përfshirë kërkesat pasuese të KRU-ve për sqarime.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Metodologjia tarifore (fajli në Excel) është zhvilluar, finalizuar me komentet e përfshira të ARRU dhe KRU-ve dhe është aprovuar. - Trajnimet për stafin e përzgjedhur të KRU-ve për përdorim të metodologjisë tarifore është mbajtur. - Metodologjia është validuar nga ARRU dhe është ndarë me KRU-të për aplikim tarifor për periudhën 2026-2028.
<p>2.3 dhe 2.8</p>	<p>Dokumenti i përmbledhur me politikat tarifore është hartuar</p>	<p>Është realizuar</p> <p>Në kuadër të zhvillimit të metodologjisë tarifore, ARRU ka rifreskuar dhe plotësuar edhe dokumentin e ‘Politikave</p>

		<p>tarifore’, dokumentin për ‘Procedurat e përcaktimit të tarifave’ dhe ‘Udhëzuesin e përdorimit të metodologjisë tarifore’. Në proces është edhe plotësimi i ‘Udhëzuesit të kontabilitetit rregullator’ dhe ‘Raporti përmbledhës i procesit tarifor 2026-2028’. Të gjitha këto dokumente përbëjnë pakon e dokumentacionit për metodologjinë tarifore.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dokumentet vijuese janë hartuar dhe janë ndarë me palët e interesit: ‘Politikat tarifore’, ‘Procedurat e përcaktimit të tarifave’, ‘Udhëzuesi i përdorimit të metodologjisë tarifore’ dhe plotësimi i ‘Udhëzuesit të kontabilitetit rregullator’ (ky i fundit është në proces)
<p>2.4, 2.5, 2.6 dhe 2.7</p>	<p>Kërkesa zyrtare për KRU-të për të plotësuar aplikacionin për aplikim tarifor për ciklin e rregullt tarifor 2026-2028 konform modulit (aplikacionit) të ri të aprovuar tarifor</p> <p>Mbajtja e komunikimit, përfshirë takimet me KRU-të dhe palët e interesit, pranimi i aplikacioneve tarifore të KRU-ve për ciklin tarifor 2026-2028 përfshirë finalizimin e propozimeve tarifore</p> <p>Definimi i caqeve tarifore në koordinim me KRU-të, analiza preliminare e përbalueshmërisë së tarifave për ciklin tarifor 2026-2028 për konsumatorët në Kosovë</p> <p>Kalkulimi, aprovimi i tarifave dhe publikimi i urdhëresës tarifore me tarifat e reja për shërbimet e ujit, ujërave të ndotura dhe për furnizim të ujit me shumicë për ciklin tarifor 2026-2028</p>	<p>Është realizuar</p> <p>Konform afateve ligjore, ARRU ka dërguar tek KRU-të kërkesën për aplikim tarifor, përfshirë edhe kërkesën për dokumentacionin tjetër shoqërues, në formë evidence që do të shërbejë si bazë për përcaktim të tarifave.</p> <p>Në kuadër të këtij procesi, ARRU ka qenë në komunikim të vazhdueshëm nga qershori deri në dhjetor 2025 me KRU-të, për të kërkuar sqarime, evidenca shtesë dhe nevojës për korrigjime të dhënave të insertuara në modulën tarifor, qoftë përmes shkresave apo takime dy-palëshe.</p> <p>Një fazë tjetër e komunikimit ka pasur të bëjë me definimin e caqeve apo parimeve tarifore, të treguesve tjerë të performancës, që janë shumë të rëndësishëm për përcaktimin e tarifave.</p> <p>Diskutimi me publikun në të gjitha regjionet në Kosovë, sipas një orari që është publikuar paraprakisht në ueb-faqen e ARRU dhe të KRU-ve, përfshirë komunikatën e ndarë me të gjitha mediat kryesore në Kosovë, ka qenë pjesë e procesit.</p> <p>Dhe hapi përfundimatar, ka qenë kalkulimi dhe lëshimi i urdhëresave tarifore për shërbimet e ujit për 7 KRU-të në Kosovë, përfshirë NHE ‘Ibër Lepenci’.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - E-maili- shkresa zyrtarë e dërguar tek KRU-të dhe NHE ‘Ibër Lepenci’, me listën e kërkesave, për të përgatitur pakon e aplikacionit tarifor për ciklin tarifor 2026-2028, - Takimet tek KRU-të apo shkresat zyrtare të dërguara tek KRU-të për sqarime plotësuese apo për kërkesë për evidenca shtesë, - Definimi i parimeve, caqeve tarifore dhe treguesve tjerë për ciklin tarifor 2026-2028, - Diskutimi me publikun/ takimet me palët e interesuara për të diskutuar propozimet për tarifa. Minutat e

		<p>takimeve janë mbajtur për çdo takim me publikun në 7 rajonet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Urdhëresat e reja tarifore/ tarifave për shërbimet e ujit për vitet 2026-2028, që janë të aplikueshme nga janari i vitit 2026, janë ndarë me 7 KRU-të dhe janë publikuar në ueb-faqen e ARRU-së.
<p>Objekti 3: Kryerja e analizave, hulumtimeve dhe publikimi i raporteve që derivojnë nga procesi tarifor</p>		
3.1	<p>Raporti i procesit tarifor 2025 përfshirë analizën e caqeve tarifore dhe përballueshmërinë e tarifave për shërbimet e ujit është finalizuar dhe publikuar</p>	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU ka inspektuar realizimin e caqeve tarifore për procesin tarifor 2022-2024 dhe veçmas për vitin 2024.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i realizimit të caqeve tarifore është hartuar dhe ndarë me KRU-të dhe me palët tjera të interesit.
3.2 dhe 3.3	<p>Vizitat inspektuese dhe monitorimi i KRU-ve lidhur me realizimin e caqeve tarifore, përfshirë hartimin e raportit të përmbushjes së caqeve për ciklin tarifor 2022-2024 të definuara me procesin paraprak tarifor</p>	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU ka inspektuar realizimin e investimeve kapitale për periudhën 2022-2024 (periudhën e procesit tarifor) dhe veçmas për vitin 2024.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i realizimit të investimeve kapitale për periudhën 2022-2024 (periudhën e procesit tarifor) dhe veçmas për vitin 2024 për të gjitha KRU-të dhe për NHE Ibër Lepenci janë hartuar dhe ndarë me palët e interesit.
3.4	<p>Kryerja e analizave dhe hulumtimeve për sa i përket ndryshimeve të metodologjisë tarifore dhe reflektimit të saj në lartësinë dhe përballueshmërinë e pagesës së e tarifave</p>	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU, me mbështetje të konsulentit ndërkombëtar, ka bërë analiza rreth ndikimeve tarifore tek konsumatorët. Megjithatë, politikat tarifore sugjerojnë se përgjegjësia për mbështetjen e personave në nevojë i takon institucioneve qeveritare, përmes mekanizmave të veçantë sociale.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Politikat tarifore specifikojnë përgjegjësin për mbështetje të ekonomive familjare me gjendje të rëndë sociale.

Synimi Strategjik 3: Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimeve kundrejt caqeve të aprovuara, udhëhequr në praktikat e benchmarkingut dhe konkurrencës

Në mandatin ligjor të ARRU është monitorimi dhe vlerësimi i trendit të zhvillimit dhe të performimit të ofruesve të shërbimeve të ujit, që të raportojë tek institucionet relevante dhe te palët e interesit për gjendjen e sektorit dhe sfidat me të cilat ballafaqohet sektori. Në këtë kuptim, ARRU përmes Departamentit për Raportim të Performancës menaxhon mbledhjen e të dhënave financiare, operative dhe të përmbushjes së standardeve të shërbimit nga KRU-të në baza tre-mujore, bën verifikimin (auditimin) e këtyre të dhënave, përpunon të dhënat e mbledhura dhe harton raportet gjysmë vjetore dhe raportet vjetore të performancës së ofruesve të shërbimit. Të dhënat e mbledhura ruhen në databazën e krijuar në MS Access dhe përditësohen me të dhënat tre-mujore që mblidhen nga KRU-të.

Lista e treguesve kyç të përformancës për matje të progresit, performancës dhe konkurrencës midis ofruesve të shërbimeve është definuar: udhëzuesi për monitorim dhe raportim të performancës së ofruesve të shërbimeve jep mundësi të përzgjedhjes së një numri relativisht të madh të treguesve të performancës.

Projekti “Integrated Water Resource Management-Kosovo (IWRM-K)“ bashkë-financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Kosovës, janë duke mbështetur ARRU-në në zhvillimin e një aplikacioni softuerik për raportim online të treguesve të performancës dhe standardeve të shërbimit. Ky aplikacion pritet të shënojë një progres në procedurat e monitorimit, mbikëqyrjes dhe auditimit të dhënave për treguesit kyç të performancës së ofruesve të shërbimit. Për më tepër ky aplikacion do të jetë një lehtësim si në aspektin e raportimit të dhënave, po edhe të gjenerimit të raporteve dhe grafikoneve të standardizuar për të gjithë treguesit e performancës. Në kuadër të këtij aplikacioni do të inkorporohet opsioni i matjes së besueshmërisë së të dhënave të raportuara, sipas kriterëve të përcaktuara nga ARRU, dhe moduli i bilancit të ujit.

Besueshmëria e të dhënave të raportuara financiare dhe operative nga ofruesit e shërbimeve është verifikuar dhe audituar prej ARRU: për ARRU-në, përveç raportimit periodik të dhënave, me rëndësi është auditimi/ verifikimi i besueshmërisë dhe saktësisë së të dhënave të raportuara. Për këtë qëllim, ARRU ka hartuar një matricë të vlerësimit të besueshmërisë me disa kategori dhe nën-kategori kërkesash që definojnë më pas besueshmërinë e treguesve të performancës. ARRU organizon vizita të rregullta tek KRU-të për të kontrolluar fletë-pas-flete të gjitha të dhënat e raportuara dhe krahasimin e tyre me të dhënat nga sistemi i kontabilitetit dhe aplikacionet tjera në prani të përfaqësuesve të secilës KRU. Në fund të procesit të auditimit, ARRU harton raportet e auditimit dhe vlerësimin e besueshmërisë së të dhënave të raportuara. Këto raporte, për çështje korrektësie, ndahen me KRU-të dhe me shkresë të veçantë listohen çështjet në të cilat KRU-të duhet bërë përmirësime. Duhet të potencohet se procesi i auditimit të dhënave bazohet tërësisht në udhëzuesin e Kontabilitetit Rregullator.

Hartimi dhe publikimi i analizave dhe raporteve që derivojnë nga auditimi i të dhënave dhe nga të dhënat raportuara të ofruesve të shërbimeve (treguesit operativ dhe financiar): një prej përgjegjësive kryesore të departamentit të raportimit të performancës është koordinimi me ofruesit e shërbimeve për të raportuar në baza të rregullta për performancën e tyre për një numër të caktuar treguesish operativ dhe financiar. Pas pranimit të dhënave, ARRU i proceson të dhënat, i inserton në databazë dhe gjeneron raporte dhe analiza sipas kërkesave dhe nevojës së vet ARRU-së dhe palëve të interesit. Raporti vjetor të performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë që hartohet dhe publikohet nga ARRU, është raporti kryesor me të cilin identifikohet sektori i shërbimeve të ujit, po edhe burim informacioni për gjendjen e sektorit për të gjitha palët e interesit.

Në tabelën 7 listuar aktivitetet e planifikuara në Planin e Performancës (2024) dhe aktivitetete të realizuara në kuadër të Synimit Strategjik 3. Po ashtu janë dhënë sqarime plotësuese në rast të mos-përmbushjes së aktiviteteteve të planifikuara.

Tabela 7. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të Synimit Strategjik 3

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
Objektivi 1: Lista e treguesve kyç të performancës për matje të progresit, performancës dhe konkurrencës midis ofruesve të shërbimeve është definuar		
1.1	Treguesit kyç të performancës për shërbimet e ujit dhe ujërat e ndotur janë rishikuar, janë definuar treguesit e rinjë të performancës që përfshijnë kriteret mjedisore dhe efijencën e energjisë, është definuar mënyra e llogaritjes, auditimit dhe vlerësimit të besueshmërisë dhe efijencën e energjisë	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU në bashkëpunim me projektin “Qëndrueshmëria Klimatike në Sektorin e Ujërave të Kosovës“ të bashkëfinancuar nga Qeveria së Zvicrës dhe Qeveria e Kosovës ka definuar 4 tregues të rinjë të performancës që do të përfshihen në raportet tre-mujore që do të raportohen nga KRU-të</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Humbjet e ujit (m³/km/ditë) - Energjia e konsumuar për prodhimin e ujit (kWh/m³) - Energjia e konsumuar për përpunimin e ujërave të ndotur (kWh/m³) - Pjesëmarrja e burimeve të renovueshme të energjisë (%).
1.2	Përcaktimi i peshës së treguesve për matje dhe krahasim të performancës së ofruesve të shërbimeve është definuar	<p>Është realizuar</p> <p>Tabela me treguesit e performancës të kategorizuar sipas peshës është hartuar, aprovuar dhe ndarë me ofruesit e shërbimeve</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lista e treguesve kyç të performancës për rangim dhe krahasim të performancës së KRU-ve është propozuar dhe aprovuar nga ARRU.
1.3	Të dhënat për treguesit kyç të performancës raportohen nga ofruesit e shërbimeve në baza të rregullta tre-mujore dhe vjetore tek ARRU për vitin 2025	<p>Është realizuar</p> <p>KRU-të raportojnë të dhënat për treguesit e performancës, sipas afateve të përcaktuara ligjore. Raportimi i të dhënave për kualitetin e ujit nga IKSHPK dhe nga Qendrat Regjionale të Shëndetit Publik realizohet në mënyrë të rregullt.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dhënat për treguesit kyç të performancës për çdo tremujor janë raportuar nga KRU-të dhe janë insertuar në bazën e të dhënave (në modulën e performancës). - Baza e të dhënave është përdatësuar me të gjithë treguesit për vitin 2025.

1.4	Monitorimi i zhvillimit dhe instalimit të aplikacionit softuerik për raportim on-line të dhënave për treguesit kyç të performancës nga ana e KRU-ve; përfshirë trajnimin e personelit të KRU-ve dhe të ARRU-së për përdorim të këtij aplikacioni	<p>Është realizuar</p> <p>Projekti “Integrated Water Resource Managment-Kosovo (IWRM-K)“ financuar nga Qeveria e Zvicrës është duke mbështetur ARRU-në në zhvillimin e një aplikacioni softuerik për raportim online të treguesve të performancës dhe standardeve të shërbimit. Moduli i standardeve të shërbimit është zhvilluar veçse, tash është duke u zhvilluar moduli për treguesit e performancës</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrata e nënshkruar midis operatorit dhe projektit IWRM-K për zhvillim të aplikacionit, - Definimi i strukturës / arkitekturës së aplikacionit, - Definimi i treguesve të performancës për raportim nga KRU-të.
Objektiva 2: Besueshmëria e të dhënave të raportuara financiare dhe operative nga ofruesit e shërbimeve është verifikuar dhe audituar prej ARRU		
2.1	Udhëzuesi për verifikimin dhe auditimin e të dhënave, procedurat, mënyra e verifikimit të dhënave dhe kriteret për kategorizim të besueshmërisë së të dhënave operative dhe financiare është përditësuar	<p>Është realizuar</p> <p>Është hartuar tabela për vlerësim të besueshmërisë së të dhënave dhe janë vënë kriteret e vlerësimit të besueshmërisë së të dhënave</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Definimi i kërkesave shtesë që definojnë më qartë besueshmërinë e treguesve të performancës (ndarja në kategori dhe nën-kategori) është realizuar.
2.2	Verifikimi dhe auditimi i treguesve kryesor të performancës së KRU për vitin 2024, përmbledhja e tyre në bazën e të dhënave	<p>Është realizuar</p> <p>Procesi i auditimit të dhënave është realizuar nga ARRU sipas kërkesave ligjore për të gjitha KRU-të dhe NHE Ibër Lepenci</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizitat verifikuese/ audituese janë realizuar tek të gjithë ofruesit e shërbimeve, - Formatet e moduleve për auditim janë plotësuar me të gjitha të dhënat e auditimit, për aspektin teknik dhe financiar.
Objektiva 3: Hartimi dhe publikimi i analizave dhe raporteve që derivojnë nga auditimi i të dhënave dhe nga të dhënat raportuara të ofruesve të shërbimeve (treguesit operativ dhe financiar)		
3.1	Analiza e të dhënave nga procesi i auditimit dhe përgatitja e raporteve të auditimit për vitin 2024	<p>Është realizuar</p> <p>Të dhënat e mbledhura gjatë procesit të auditimit janë analizuar në mënyrë kritike nga ana e ARRU-së</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Draft raportet e auditimit janë dërguar tek KRU-të për komente,

		<ul style="list-style-type: none"> - Raportet e Auditimit janë finalizuar dhe janë publikuar në ueb-faqen e ARRU-së, - Është dërguar shkresë zyrtare tek të gjitha KRU-të lidhur me gjetjet nga procesi i auditimit dhe inspektimit.
3.2	Analiza e të dhënave të raportuara për treguesit kyç të performancës, hartimi dhe publikimi i raportit vjetor të performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit per vitin 2024	<p>Është realizuar</p> <p>Të dhënat e raportuara për treguesit kyç të performancës janë analizuar, insertuar në databazën dhe janë përmbledhur në raportin vjetor të performancës</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti vjetor i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit në Kosovë për vitin 2024 është hartuar dhe publikuar ueb-faqen e ARRU-së
3.3	Publikimi i raportit të performancës për gjysmëvjetorin e parë të vitit 2025	<p>Është realizuar</p> <p>Të dhënat e raportuara për treguesit kyç të performancës për H1-2024 janë analizuar dhe janë përmbledhur në raportin e gjysmë-vjetor</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lista e treguesve të përfshirë në raportin H1-2025 është definuar. - Raportet gjysmë-vjetor i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit në Kosovë për H1-2025 është hartuar.
3.4	Organizimi i punëtorisë apo tryezës së rrumbullakët me të gjitha palët e interesit për të diskutuar performancën dhe arritjen e progresit në sektorin e shërbimeve të ujit	<p>Nuk është realizuar</p> <p>Duke qenë se nuk është bërë rangimi i KRU-ve sipas performancës, ARRU nuk kishte organizuar punëtorinë për publikimin e raportit të performancës. Megjithate, Raporti i Performancës është ndarë me të gjitha palët e intereseit dhe është publikuar në ueb-faqen e ARRU-së, si referencë e gjendjes së sektorit të shërbimeve të ujit.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i performancës së shërbimeve të ujit është ndarë dhe publikuar me palët e interesit në Kosovë.

Synimi Strategjik 4: Monitorimi dhe inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe besueshmërisë së të dhënave

Përmbushja e Standardeve të Shërbimit është një nga përgjegjësitë ligjore shumë të rëndësishme në të cilat fokusohet ARRU gjatë inspektimit vjetor të ofruesve të shërbimit, që zbatohet dhe ekzekutohet nga Njësia e Inspektimit. Të dhënat që mbledhen gjatë vizitave inspektuese insertohen dhe ruhen në Modulet e Inspektimit dhe përmbledhen në ‘Raportin për Nivelin e Shërbimeve të ofruara nga Ofruesit e Licencuar të Shërbimeve – Përputhshmëria me Kushtet e Licencës’ dhe publikohet në ueb-faqen e ARRU-së për informim të publikut me nivelin e shërbimeve të ujit që ofrohen nga kompanitë publike të licencuara.

Realizimi i aktiviteteve të planifikuara të Njesisë për Inspektim për vitin 2025 ka qenë i vështirësuar për shkak të kufizimeve në kapacitetet njerëzore. Njëra nga zyrtaret e njësisë (inspektorja) ka qenë në pushim të lehonisë gjatë periudhës tetor 2024 – tetor 2025, ndërsa udhëheqësja e njësisë, pas rikthimit nga pushimi mjekësor, ka qenë e angazhuar intensivisht në mbikëqyrjen e zhvillimit dhe implementimit të platformës softuerike tek KRU-të, si dhe në planifikimin dhe realizimin e trajnimeve për Sistemin Informativ të Shërbimeve të Ujit (SISHU).

Organizimi i inspektimeve tek ofruesit e shërbimeve për të verifikuar nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit: gjatë vitit 2025 fokusi kryesor i ARRU-së, përkatësisht i udhëheqëses së njësisë së inspektimit, ka qenë në funksionalizimin (zhvillimin dhe finalizimin e plotë të e platformës on-line të raportimit – SISHU).

Për dallim nga vitet e kaluara kur të gjitha të dhënat janë përgatitur nga KRU-të në formularë në Excel sipas formateve të para-dizajnuara nga ARRU dhe janë raportuar deri në muajin mars. Të dhënat për standardet e shërbimit për vitin 2025 janë duke u insertuar drejtpërdrejt në aplikacionin/ platformën softuerike për raportim on-line të dhënave. Po ashtu në databazën e këtij aplikacioni / platforme janë të insertuara edhe të dhënat historike të viteve paraprake.

Platforma online është emërtuar **Sistemi Informativ i Shërbimeve të Ujit (SISHU)** dhe është regjistruar pranë Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Kjo platformë softuerike paraqet një avancim të konsiderueshëm për ARRU-në dhe një qasje krejt të re të ndërveprimit me KRU-të. Duke parë përparësitë që ofron kjo mënyrë e raportimit, për KRU-të ashtu edhe për ARRU-në, është vendosur që kjo platformë të zgjerohet me modulet e performancës dhe të tarifave gjatë vitit 2026. Gjatë vitit 2025 janë realizuar trajnimet e nevojshme për personelin e KRU-ve për përdorim të kësaj platforme, po edhe për stafin e ARRU-së për monitorim, procesim/ krijim të tabelave, garfikoneve të nevojshme për raportim.

Gjatë tërë vitit 2025 janë mbajtur takime me zhvilluesit e SISHU më qëllim të sqarimit më të detajuar rreth kërkesave të lidhura me standardet e shërbimit, mënyrën e kalkulimit dhe vlerësimit të treguesve, mënyrën e raportimit nga KRU-të dhe gjenerimin e raporteve përmes SISHU. Janë mbajtur shtatë punëtori të përbashkëta dhe të ndara (në secilën KRU) për trajnimin e personave përgjegjës të KRU-ve për mënyrën e përdorimit të SISHU dhe për insertimin e të dhënave.

Zhvillimi i platformës SISHU është pritur mjaftë mirë nga të gjitha palët e interesit brenda dhe jashtë Kosovës, si e tillë është prezantuar në konferencën e përbashkët vjetore të ujit SHUKOS – SHUKALB. Me kërkesë të Entit Rregullator të Ujit të Shqipërisë dhe të Komisionit Rregullator për Ujë dhe Energji të Maqedonisë së Veriut është bërë prezantimi i platformës SISHU.

Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare: në kuadër të këtij aktiviteti, udhëheqësja e njësisë së inspektimit ka kryer detyrat vijuese:

- **Pjesëmarrja në komisionin për ujin të destinuar për konsum njerëzor:** me vendim të Qeverisë së Kosovës është themeluar Komisioni për Ujin e Destinuar për Konsum Njerëzor. IKSHKP ka udhëhequr dhe ka ftuar takime mujore të këtij komisioni. Një prej çështjeve më komplekse me të cilën është marrë ky komision ka qenë shfaqja e problemit të manganit në liqenin akumulues në Badovc dhe pa mundësia e përpunimit të ujit në IPU Badovc.

Në kuadër të kësaj problematike, ARRU (zëvendës drejtori dhe udhëheqësja e njësisë së inspektimit) të koordinuar me IKSHKP dhe KRU Prishtina, kanë bërë një hulumtim të performancës së impiantit të përpunimit të ujit në Badovc. Hulumtimi kryesisht ishte fokusuar në analizimin dhe optimalizimin e dozimit të kemikalieve për largimin/ oksidimin e manganit. Për këtë qëllim janë dhënë disa rekomandime për personelin që operon impiantin në Badovc dhe është dizajnuar një kalkulator për llogaritje të dozës së permanganatit të kaliumit në ujë, në varësi të përqendrimit të manganit në ujin e pa përpunuar. Pas zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe zbatimit të formulës për dozim të permanganatit të kaliumit, situata me përqendrimin e lartë të manganit ishte tejkaluar.

- **Raportimi për ZKM:** udhëheqësja e njësisë së inspektimit, në bashkëpunim me të gjitha departamentet e ARRU, koordinon dhe i përcjell të dhënat e kërkuara tre-mujore për sektorin e shërbimeve të ujit tek zyrtarët përkatës në ZKM, për raportim të mëtejshëm në Komisionin Europian.
- **Person kontaktues i ARRU me Programin për Menaxhimin të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K):** ky program, që bashkë-financohet nga Qeveria e Zvicrës dhe e Kosovës, ka mbështetur ARRU-në në zhvillimin e një platforme softuerike (sistemi informativ për shërbimet e ujit) për raportim on-line të dhënave prej KRU-ve në lidhje me standardet e shërbimit. Udhëheqësja e njësisë për inspektim ka bashkëpunuar me zhvilluesit e platformës softuerike, me qëllim që kjo platformë të jetë e përshtatshme dhe ti plotësojë kërkesat e ARRU-së sa i përket raportimit për standardet e shërbimit. Përgjatë vitit 2024 janë organizuar trajnimet për stafin përgjegjës të KRU-ve për përdorim dhe për raportim të dhënave on-line. Platforma është funksionalizuar plotësisht gjatë vitit 2025.
- **Person kontaktues i ARRU me Projektin Qëndrueshmëria Klimatike në Sektorin e Ujërave në Kosovë:** ky projekt, që bashkë-financohet nga Qeveria e Zvicrës dhe e Kosovës, mbështetë KRU-të në çështjet e zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe të efijencës së energjisë.
- **Person për ndërlidhje dhe komunikim me WAREG:** Në cilësinë e personit kontaktues me WAREG ka marrë pjesë në takimet e rregullta dhe në punëtorinë e tretë të projektit të TAIEK (projekt ky i financuar nga Komisioni Evropian dhe i implementuar nga WAREG) në Lisbonë/Portugali, ka marrë pjesë në takime online të organizuara nga grupet punuese të WAREG, kontribut në përgatitjen e prezantimeve të ARRU për WAREG, etj.

Në tabelën 8 janë listuar aktivitetet e planifikuara në Planin e Performancës (2025) dhe aktivitetet të realizuara në kuadër të Synimit Strategjik 4. Po ashtu janë dhënë sqarime plotësuese në rast të mos-përmbushjes së aktiviteteteve të planifikuara.

Tabela 8. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të Synimit Strategjik 4

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
Objektivi 1: Organizimi i inspektimeve tek ofruesit e shërbimeve për të verifikuar nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit		
1.1	<p>Organizimi i inspektimeve të rregullta vjetore për përmbushje të standardeve të shërbimit sipas kushteve të licencës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e formularëve të inspektimit dhe ndarja me zyrtarët e KRU-ve - Përditësimi i të dhënave në Modulin për Inspektimin e standardeve të shërbimeve të ujit 	<p>Është realizuar pjesërisht</p> <p>Në vitin 2025, pas zhvillimit të platformës softuerike SISHU, realizimi i aktivitetit është ndikuar nga procesi i implementimit të sistemit. Gjatë kësaj periudhe, vizitat në terren janë shfrytëzuar edhe për mbështetje të KRU-ve në përdorimin e sistemit dhe për regjistrimin e të dhënave në platformën SISHU.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Platforma SISHU më gjitha të dhënat e standardeve të shërbimit është funksionalizuar. - Trajnimet e përbashkëta me të gjitha KRU-të dhe individuale, për secilën KRU veç-e-veç janë realizuar. - Të gjitha KRU-të kanë qasje në sistem për raportimin e të dhënave. - ARRU-së i është krijuar domeni për qasje, për kontrollim/ inspektim të dhëanve të insertuara dhe për aprovim/ validim të dhënave të KRU-ve.
1.2	<p>Organizimi i inspektimeve tematike me qëllim të verifikimit të ekzistencës dhe zbatimit të procedurave për kyçjen e konsumatorëve në shërbimet e ujit dhe ujëravë të ndotur</p> <ul style="list-style-type: none"> - Verifikimi i zbatimit të përgjegjësive duke filluar nga aplikimi i konsumatorit për kyçje deri te pranimi teknik i kyçjes dhe regjistrimi i konsumatorëve në databazën e KRU, respektimi i afateve kohore 	<p>Nuk është realizuar</p> <p>Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë vitit 2025 për shkak të angazhimit prioritar në zhvillimin dhe funksionalizimin e platformës SISHU, si dhe kufizimeve në kapacitetet njerëzore të Njesisë për Inspektim.</p>

<p>1.3 dhe 1.4</p>	<p>Organizimi i inspektimeve tematike për çështje që identifikohen si problematike në aspektin e përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore dhe</p> <p>Organizimi i inspektimeve verifikuese me qëllim konfirmimi të zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve paraprake tematike nga ofruesit e shërbimeve</p>	<p>Është realizuar</p> <p>Vizitat tek KRU Prishtina / IPU Badovc lidhur me përqendrimin e lartë të manganit në ujin e përpunuar.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në takime të Komisionit Qeveritar për për ujin të destinuar për konsum njerëzor. - Takimet trepalëshe ARRU/ IKSHPK/ KRU Prishtina, përfshirë herë-pas-herë edhe Agjencinë e Ushqimit për të diskutuar çështjen e kualitetit të ujit në IPU Badovc dhe masat ligjore që duhet ndërmarrë. - Vizitat në IPU Badovc për të inspektuar gjendjen aktuale dhe për të konfirmuar zbatimin e masave të rekomanduara nga ARRU.
<p>1.5</p>	<p>Monitorimi i zhvillimit dhe instalimit të aplikacionit softuerik për raportim on-line të dhënave për standardet e shërbimeve nga ana e KRU-ve; përfshirë trajnimin e personelit të KRU-ve dhe të ARRU-së për përdorim të këtij aplikacioni</p>	<p>Është realizuar</p> <p>Platforma SISHU më gjitha të dhënat e standardeve të shërbimit është funksionalizuar.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Platforma SISHU është funksionalizuar. - Trajnimet e përbashkëta me të gjitha KRU-të dhe trajnimet individuale, për secilën KRU veç-e-veç, janë realizuar. - Të gjitha KRU-ve iu është krijuar domeni për qasje dhe për insertim të dhënave. - ARRU-së i është krijuar domeni për qasje, për kontrollim/ inspektim të dhënave të insertuara dhe për aprovim/ validim të dhënave të KRU-ve.
<p>1.6</p>	<p>Monitorimi i përdorimit të aplikacionit softuerik nga KRU-të, dizajnimi i grafikoneve & tabelave të personalizuar që do të gjenerohen sipas nevojave të ARRU-së dhe KRU-ve</p>	<p>Është realizuar</p> <p>Gjatë tërë vitit 2025 është punuar bashkarisht me KRU-të dhe me zhvilluesit e platformës për trajnimin e stafit për përdorim dhe insertim me kohë (sipas afateve të përcaktuara) të dhënave të kërkuara.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dhënat për vitin 2025 janë insertuar. - Të dhënat historike, për vitet paraprake, po ashtu janë insertuar. - Platforma lejon mundësin e gjenerimit të raporteve standarde, tabelave dhe grafikoneve sipas nevojës së KRU dhe të ARRU.
<p>Objektiva 2: Kryerja e analizave dhe publikimi raporteve që derivojnë nga inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe raportimet tjera</p>		
<p>2.1</p>	<p>Analiza e të dhënave nga procesi i inspektimit të rregullt dhe përgatitja e raportit të inspektimit</p>	<p>Nuk është realizuar</p>

	të përmbushjes së standardeve të shërbimit	Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë vitit 2025 për shkak të implementimit të sistemit SISHU dhe kufizimeve në kapacitetet njerëzore. Treguesit e matjes: - Nuk është hartuar dhe publikuar raporti për nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit.
2.2	Analiza e të dhënave nga procesi i inspektimit tematik dhe përgatitja e raporteve të inspektimit tematik për çështje të identifikuara si kritike në sektorin e ujit	Është realizuar Pas takimeve dhe vizitave në IPU Badovc është hartuar raporti me gjetjet dhe me rekomandimet përkatëse. Treguesit e matjes: - Raporti i inspektimit tematik është hartuar dhe është ndarë me KRU dhe IKSHPK.

Synimi Strategjik 5: Nxitja e zhvillimit institucional të ARRU-së, mirëmbajtja dhe krijimi i partneritetit për t'u përballur me sfidat në rritje të sektorit

ARRU, duke qenë institucion me rëndësi në sektorin e ujit, i ka dhënë rëndësi të posaqme ngritjes profesionale të stafit të saj dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për intensifikimin e komunikimit me të gjitha palët e interesit në sektorin e ujit në Kosovë, si: Ministrinë e Ekonomisë (MeE), Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHKP), Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU), Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës (AMK) dhe me akterët ndërkombëtar që janë të involvuar në mbështetjen e sektorit të ujit në Kosovë, si: Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), Bankën Botërore (BB), Zyren Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC/SECO), Ambasadën Franceze, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Rregullatorët e Ujit në Evropë (WAREG) dhe me rregullatorët e ujit në regjion, në veçanti me Entin Rregullator të Shqipërisë (ERRU) dhe Rregullatorin e Maqedonisë (ERC).

Ngritja profesionale dhe institucionale e ARRU-së si autoritet i pavarur, i pa anshëm për rregullim të shërbimeve të ujit: në lidhje me këtë aktivitet stafi i ARRU-së ka marrë pjesë nëpër këto trajnime

- 1) Pjesëmarrja e stafit të ARRU-së (4 zyrtar) në trajnimin e financuar nga TAIEX në Romë që ka trajtuar temat vijuese:
 - Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave në sektorin e ujit.
 - Shkëmbim përvojash dhe praktikash të inspektimit dhe auditimit të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve.
- 2) Pjesëmarrja e stafit të ARRU-së (3 zyrtar) në trajnim tre-ditor të organizuar nga IKAP ka trajtuar temat:
 - Trajnim për Reduktimin e Barrës Administrative dhe Design Thinking.
- 3) Pjesëmarrja e stafit të ARRU-së (1 zyrtar) në trajnim që ka trajtuar temat vijuese:
 - Bazat e Mbrojtjes së të Dhënave
- 4) Pjesëmarrja e stafit të ARRU-së (3 zyrtar) në trajnimin e financuar nga TAIEX në Shkup që ka trajtuar temat vijuese:
 - Rregullimi i Sektorit të Ujit
 - Praktikrat dhe procedurat e trajtimi të ankesave të konsumatorëve midis rregullatoreëve të ujit.

5) Pjesëmarrja e stafit të ARRU-së (12 zyrtar) në takimin përbashkët midis rregullatorit të Shqipërisë (ERRU) dhe rregullatorit të Kosovës (ARRU) në Pogradec me qëllim të shkëmbimit të përvojave midis dy rregullatorëve për temat vijuese:

- Performanca e Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime në Shqipëri dhe Kompanive Rajonale të Ujit në Kosovë,
- Prezantimi i ndryshimeve/ rishikimit në metodologjinë tarifore të ERRU dhe ARRU,
- Inspektimet e përmbushjes së standardeve të shërbimit,
- Sfidat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve në Shqipëri dhe në Kosovë,
- Ndarje e përvojave dhe diskutimi i hapur për të gjitha temat e prezantuara më lartë.

Pra, shumica e zyrtarëve të ARRU-së kanë qenë të përfshirë në trajnime në fushat përkatëse përmes pjesëmarrjes fizike. Veç kësaj një numër tjetër i zyrtarëve kanë marrë pjesë në trajnime që organizohen on-line në fushat që janë me rëndësi për ARRU-në.

Promovimi i komunikimit ndër-institucional me të gjitha palët e interesit për të identifikuar sfidat dhe për të avancuar reformimin dhe zhvillimin e sektorit të ujit: ARRU ka vlerësuar si tejet të rëndësishme komunikimin ndër-institucional me qëllim të adresimit të problemeve në sektor dhe për strategjinë zhvillimore të sektorit të shërbimeve të ujit. ARRU ka pasur takime me MeE dhe me MMPHI në nivel të zëvendës ministrave. Janë ngritur disa çështje që nga perspektiva e ARRU-së kërkojnë adresim urgjent, si: çështja e pajisjes me leje ujore të burimeve të ujit që shfrytëzohen nga KRU-të, harmonizimin e emërtimeve të burimeve të ujit, procesi i licencimit të KRU-ve – veçmas licencimi i KRU Mitrovica për zgjerim të zonës së shërbimit me 4 komunat në veri të Kosovës, performanca jo e mirë e KRU-ve dhe orientimi i investimeve në sektorin e ujit. Me MeE kemi pasur mirëkuptim në disa çështje, ndërsa me MMPHI asjera nga çështjet e ngritura nuk është adresuar.

Avancimi i komunikimit me rregullatorët dhe institucionet tjera ndërkombëtare për të ndarë përvojat dhe praktikat e mira rregullatore për zhvillim të sektorit të ujit: ARRU ka kultivuar një komunikim shumë konstruktiv me rregullatorët e ujit në Evropë dhe në regjion, e po ashtu ka pasur komunikim jashtëzakonisht të mirë dhe mirëkuptim të plotë me agjencionet donatore që mbështesin sektorin e ujit në Kosovë. Falë këtij bashkëpunimi të mirë ARRU ka marrë mbështetje financiare për rishikimin e metodologjisë tarifore (mbështetje nga KfW), mbështetje nga **Programi për Menaxhimi të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K)** për zhvillimin e platformës softuerike për raportim on-line të të dhënave nga KRU-të, ka siguruar pjesëmarrje në trajnimet dhe shkëmbimet e përvojave të organizuara nga WAREG në Portugal dhe në Firencë.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi të ngushtë dhe të frytshëm me WAREG, drejtoresha e ARRU-së është përzgjedhur si koordinatore e rregullatorëve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe merr pjesë në bordin e WAREG-ut si përfaqësuese e rregullatorëve të rajonit. Po ashtu, ARRU është përzgjedhur bashkëkryesues i grupit punues për tarifën e shërbimit. Në këtë kontekst, përfaqësuesi i ARRU në bashkëpunim me sekretarin e WAREG, ka analizuar përgjegjet e pyetësorit që përfshijnë të gjitha çështjet lidhur me tarifën e shërbimeve dhe ka bërë prezantimin e praktikave për të gjitha anëtarët e WAREG.

Mbështetja e integritit të sistemeve rurale dhe urbane nën menaxhim të ofruesve të licencuar të shërbimeve: ARRU në takimet me MeE, MMPHI dhe me KRU-të ka ngritur çështjen e integritit të sistemeve rurale. Në takime është kërkuar që grantet e Qeverisë që u jepen KRU-ve të orientohen për rehabilitim të sistemeve ekzistuese në zonat rurale, të cilat kanë probleme

teknike, e kjo pastaj do të krijonte kushte që KRU-të t’i marrin nën menaxhim dhe mos të degradohet edhe më shumë gjendja e tyre.

Në tabelën 9 janë listuar aktivitetet e planifikuara në Planin e Performancës (2024) dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të Synimit Strategjik 5. Po ashtu janë dhënë sqarime plotësuese në rast të mos-përmbushjes së aktivitetetëve të planifikuara.

Tabela 9. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të Synimit Strategjik 5

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
Objektiva 1: Ngritja profesionale dhe institucionale e ARRU-së si autoritet i pavarur, i pa anshëm për rregullim shërbimeve të ujit		
1.1	Trajnimi profesional i stafit për çështje rregullative/ ligjore, metodologjisë tarifore, monitorimit të performancës, inspektimit të standardeve të shërbimit dhe aspekte tjera relevante të sektorit të ujit	<p>Është realizuar</p> <p>Gjatë vitit 2025 janë realizuar trajnime për stafin e ARRU-së, në të gjitha fushat relevante dhe me pjesëmarrje të stafit të gjithë departamenteve dhe niveleve.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrje e stafit të ARRU në trajnime profesionale të organizuar nga IKAP (5 zyrtar); - Pjesëmarrje e stafit të ARRU në trajnime profesionale dhe shkëmbim përvojash financiar nga TAIEK në Romë (4 zyrtar); - Pjesëmarrje e stafit të ARRU në trajnime profesionale dhe shkëmbim përvojash financiar nga TAIEK në Shkup (3 zyrtar); - Pjesëmarrje e stafit të ARRU në punëtorinë për shkëmbim përvojash midis ERU dhe ARRU në Kosovë në të gjitha fushat (12 zyrtar);
1.2	Pjesëmarrja në forume dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare me qëllim shkëmbimin e përvojave me rregullatorët e shërbimeve të ujit në regjion dhe në Europë	<p>Është realizuar.</p> <p>ARRU merr pjesë aktive në forume dhe konferenca vendore, regjionale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e drejtoreshës së ARRU-së si paneliste e takimeve vjetore të SHUKOS-SHUKALB; - Pjesëmarrja e ARRU-së në takimet e rregullta të Asamblesë së WAREG-ut; - Përzgjedhja e ARRU si bashkë-kryesues i Grupit Punues për Tarifa dhe për hartimin e Raportit për Metodologjitë dhe Praktikë Tarifore të aplikuar në shtetet anëtare të WAREG. - Pjesëmarrja në konferenca dhe forume në Kosovë ku janë trajtuar problematikat e sektorit të shërbimeve të ujit.

Objektiva 2: Promovimi i komunikimit ndër-institucional me të gjitha palët e interesit për të identifikuar sfidat dhe për të avancuar reformimin dhe zhvillimin e sektorit të ujit		
2.1	Komunikimi, bashkëpunimi ndër-institucional dhe harmonizimi i qëndrimeve për zhvillim të sektorit të ujit	<p>Është realizuar</p> <p>Janë realizuar takime me MeE dhe MMPHI për të diskutuar çështje të sektorit të ujit.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtoresha dhe Zv. Drejtori i ARRU-së kanë realizuar dy takime në nivel zv. ministrash me MeE dhe MMPHI. Minutat e takimit janë hartuar dhe ndarë me pjesëmarrësit e takimit. - Pjesëmarrja në takime dhe forume të tjera me rëndësi për zhvillimin e sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë.
Objektiva 3: Avancimi i komunikimit me rregullatorët dhe institucionet tjera ndërkombëtare për të ndarë përvojat dhe praktikatat e mira rregullatore për zhvillim të sektorit të ujit		
3.1	Komunikimi dhe bashkëpunimi me akterët ndërkombëtar të involvuar në sektorin e ujit (donatorët, rregullatorët e ujit, forumet ndërkombëtare, etj.)	<p>Është realizuar</p> <p>Gjatë vitit 2025 ARRU ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me partnerët ndërkombëtar të involvuar në sektorin e ujit, ka marrë pjesë aktive në takimet e asamblesë së përgjithshme të WAREG dhe në trajnimet e organizuara nga WAREG (të financuara nga TAIEX).</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takime bilaterale me projektin IWRM-K, zhvillimi i platformës softuerike për modulën e standardeve të shërbimit, - Takime bilaterale me KfW për zhvillimet në sektorë, investimet e KfW për KRU Prishtina, mbështetja e ARRU-së për rishikimin e metodologjisë tarifore, - Takime bilaterale me USAID (Tetra TECH) për të mbështetur hartimin e udhëzuesit dhe planeve të menaxhimit të thatësiësë. - Pjesëmarrje aktive në katër (4) takimet e asamblesë së përgjithshme të WAREG-ut. Drejtoresha e ARRU-së është përzgjedhur si koordinatore e rregullatorëve regjional të ujit në kuadër të WAREG. - Bashkëkryesimi i grupit punues për tarifën e shërbimeve të ujit; analiza e metodologjive tarifore dhe praktikave tarifore të shfrytëzuara nga shtetet anëtare të WAREG, hartimi i prezantimeve.
Objektiva 4: Mbështetja e integritetit të sistemeve rurale dhe urbane nën menaxhim të ofruesve të licencuar të shërbimeve		
4.1, 4.2,	Monitorimi i ofruesve të shërbimeve lidhur me përtëritjen e lejeve ujore,	<p>Është realizuar</p> <p>Duke qenë se licencimi i ofruesve të shërbimeve është i lidhur me procesin e përtëritjes së lejeve ujore nga MMPHI, ARRU e</p>

	<p>vazhdimi i komunikimit me MMPHI dhe KRU-të që të evitohen pengesat për lëshim të lejeve ujore dhe</p> <p>Komunikimi me MMPHI lidhur me përtëritjen dhe harmonizimin e emërtimeve të burimeve në lejet ujore</p>	<p>ka konsideruar si çështje ku duhet të ketë progres të shpejtë, pasi licencat e shërbimit skadojnë në vitin 2026. Duhet theksuar se të gjitha lejet ujore, për të gjitha burimet e ujit të shfrytëzuara nga KRU-të kanë skaduar në shtator të 2023.</p> <p>Gjatë vitit 2025 ARRU ka shqyrtuar dhe ka licencuar KRU Mitrovica për marrjen në menaxhim të 4 komunave në veri të Kosovës.</p> <p><u>Treguesit e matjes:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Takime midis ARRU-së, MMPHI dhe KRU-ve janë organizuar, por asnjë rezultat nuk është arritur; - Është lëshuar licenca për KRU Mitrovica për marrje në menaxhim të 4 komunave në veri të Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok).
<p>4.3, 4.4</p>	<p>Mirëmbajtja e databazës në të cilën janë të regjistruar të gjithë të ofruesit e shërbimeve të licencuar, si dhe përditësimet me informacionet e reja dhe</p> <p>Monitorimin dhe evidentimin e rasteve, kur ofruesit e shërbimeve nuk kanë raportuar në ARRU për ndryshimet eventuale në zgjerim të zonave të shërbimit apo dhe mos ofrimin e plotë të shërbimit</p>	<p>Është realizuar</p> <p>ARRU në vazhdimësi përditëson databazën me të dhënat kryesore për ofruesit e shërbimeve të licencuar, si dhe përditësimet me të dhënat për mbulueshmëri të zonës së shërbimit.</p> <p><u>Treguesit e matjes:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Databaza me të gjitha të dhënat e nevojshme për ofruesit e shërbimeve dhe mbulueshmërisë së zonës me shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura janë të përditësuara
<p>4.3</p>	<p>Hartimi i raportit rreth përputhshmërisë me kushtet e licencës</p>	<p>Nuk është realizuar</p> <p>Nuk është realizuar gjatë vitit 2025 për shkak të implementimit të sistemit SISHU dhe kufizimeve në kapacitetet njerëzore</p> <p><u>Treguesit e matjes:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk është hartuar raport i veçantë për përputhshmërinë me kushtet e licencës

Synimi Strategjik 6: Sigurimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU

Përgjegjësia e Departamentit të Administratës dhe Financave është të përkrahë dhe mbështesë funksionimin dhe monitorimin e brendshëm të ARRU, përmes menaxhimit të buxhetit dhe financave të autoritetit, menaxhimit të burimet njerëzore dhe asetëve të autoritetit, përfshirë aktivitetet logjistike për mbarëvajtje të punëve dhe aktivitetëve të rregullta të Autoritetit.

Departamenti i administratës dhe financave është përgjegjës që në baza të rregullta vjetore të hartojë raportet financiare për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe për Kuvendin e Kosovës, të përkrahë ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve të regjistrimit, menaxhimit e dokumentacionit dhe të dhënave, protokollimit, klasifikimit, arkivimit e dokumenteve, përditësimin e sistemit të informacionit dhe web-faqes së ARRU-së.

Departamenti i administratës dhe financave komunikon në baza të rregullta me KRU-të për vjeljen e taksave vjetore të licencimit (TVL), të cilën KRU-të janë të obliguara të paguajnë për funksionimin e ARRU-së. Mirëmbajtja dhe ofrimi i shërbimeve të teknologjisë informative si: mirëmbajtja hardware-it, software-it dhe mirëmbajtja dhe publikimi i njoftimeve, lajmeve / informatave dhe dokumenteve në web-faqe të ARRU administrohet po ashtu përmes departamentit të administratës dhe financave. Në tabelën 10 janë përmbledhur aktivitetet e realizuara nga departamenti i administratës dhe financave.

Tabela 10. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të Synimit Strategjik 6

#	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi
Objektivi 1: Planifikimi dhe administrimi operativ dhe financiar		
1.1	Mbyllja e vitit fiskal 2024 dhe hapja e vitit fiskal 2025	<p>Është realizuar.</p> <p>Mbyllja e vitit fiskal 2024 dhe hapja e vitit fiskal 2025 është bërë me sukses dhe sipas afateve ligjore.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasqyrat financiare për vitin 2024 janë audituar dhe dorëzuar tek Ministria e Financave, - Raporti i auditorit nuk ka asnjë gjetje dhe asnjë rekomandim për vitin fiskal 2024, - Shpenzimet për vitin fiskal 2025 janë inicuar konform procedurave dhe planifikimeve.
1.2	Monitorimi dhe menaxhimi i buxhetit të ARRU, sipas ndarjeve të aprovuara buxhetore nga Thesari dhe Kuvendi i Kosovës, dhe raportimi i rregullt financiar tek thesari	<p>Është realizuar.</p> <p>ARRU ka menaxhuar me buxhetin e saj (shpenzimet dhe arkëtimet) në mënyrë shumë të suksesshme.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani i shpenzimeve është realizuar në nivelin 82.46% krahasuar me planifikimet.
1.3	Hartimi i buxhetit dhe planit të shpenzimit të parasë për operim të ARRU për vitin pasues dhe dorëzimi i të njëjtit tek Ministria e Financave (Thesari) dhe tek Kuvendin e Kosovës	<p>Është realizuar.</p> <p>ARRU ka hartuar dhe dorëzuar të gjitha raportet tek institucionet mbikëqyrëse (Parlamenti i Kosovës dhe Minsitria e Financave - Thesari) konform kërkesave ligjore.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti financiar është hartuar dhe është dorëzuar me kohë tek institucionet relevante (Parlamenti i Kosovës dhe tek Minsitria e Financave).
1.4	Prokurimi për mallra dhe shërbime për nevoja të ARRU	<p>Është realizuar.</p> <p>Prokurimet që kanë qenë të planifikuara në buxhetin për vitin 2025 (dhe të cilat kanë qenë nën kontrollin e ARRU-së) janë realizuar duke respektuar procedurat dhe afatet ligjore.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha mallrat dhe shërbimet e blera janë pranuar nga ARRU gjatë vitit 2025.

1.5	Regjistrimi dhe mirëmbajtja e aseteve	<p>Është realizuar.</p> <p>Databaza e aseteve të ARRU-së mirëmbahet duke respektuar procedurat dhe kërkesat ligjore.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrimi i aseteve është kryer në fund të vitit 2025 konform kërkesave ligjore. - Lista e aseteve është regjistruar në programin e-Pasuria. - Raporti i vlerësimit të pasurisë dhe raporti për tjetërsim të pasurisë jo financiare është hartuar dhe aprovuar.
1.6	Komunikimi mujor me KRU-të dhe vjelja e taksave vjetore të licencave nga KRU-të	<p>Është realizuar.</p> <p>ARRU iu faturon KRU-ve taksën vjetore të licencimit (TVL), e cila transferohet në buxhetin e konsoliduar të Kosovës bazuar në kornizën ligjore të aplikueshme.</p> <p>Treguesit e matjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dërgesa e kësteve mujore tek KRU-të për pagesë të taksës vjetore të licencimit. - Vjelja e taksës vjetore të licencimit nga KRU-të është realizuar në nivelin 96.1%. Gjatë vitit 2025 është arritur të mblidhen edhe borxhet e vjetra nga ofruesit e shërbimeve (referoju raportit financiar). - Monitorimi i pagesës së faturave nga KRU-të, në rast mos pagese, dërgimi i njoftimeve dhe paralajmërimeve për mos pagesë të TVL.
1.7	Administrimi dhe organizimi i logjistikës lidhur me operimin e ARRU	<p>Është realizuar</p> <p>Falë planifikimit dhe logjistikës së organizuar mirë, ARRU me sukses ka organizuar funksionimin e saj në nivel tejet të lartë.</p>

6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET

ARRU gjatë vitit 2025 është angazhuar me kapacitetet e saj profesionale me të gjitha palët e interesit për avancimin e sektorit të ujit. Angazhimi i ARRU-së ka qenë i fokusuar në promovimin e një klime të bashkëpunimit transparent ndër-institucional, ku secili institucion do të jepte kontributin në fushën e vet të përgjegjësisë.

Përkundër arritjeve dhe avancimit të sektorit të ujit nga viti në vit, gjendja nuk është e kënaqshme; mungojnë plane dhe strategji të koordinuara (aftashkurtëra, afatmesme dhe afatgjata) ku do të listoheshin prioritetet e zhvillimit të sektorit. Nga këndvështrimi i ARRU-së, sfidat kryesore me të cilat po ballafaqohet sektori i ujit, e që kanë pasur ndikim edhe te puna dhe funksionimi i ARRU-së janë listuar si në vijim:

Procedimi më tej i draft ligjit për “Autoritetin Rregullator dhe Rregullimin e Shërbimeve të Ujit” i hartuar nga ARRU

- Hartimi i këtij ligji është paraparë në Planin e Veprimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027. ARRU me kërkesë të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka hartuar dhe dorëzuar draftin e propozuar të ligjit të ri-formuluar në maj të vitit 2022 dhe që nga atëherë Komisioni nuk ka proceduar tutje. Përmes këtij draft ligji, ARRU beson se do të definoreshin më qartë roli dhe përgjegjësitë e ARRU-së, do të definoreshin përgjegjësitë dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve, do të ri-definoreshin politikat taifore, në veçanti për sa i përket reflektivitetit të tarifave për shërbimet e ujërave të ndotur, vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre standardeve dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Rritja e numrit të stafit të ARRU-së:

Sfidë me ndikim të madh në operimin efektiv të ARRU-së është vazhdimi i aktiviteteve me numër të vogël të stafit.

- Zgjerimi i vazhdueshëm i zonës së shërbimit të KRU-ve, vetdijësimi i konsumatorëve për t'u ankuar për shërbimet që nuk ofrohen sipas standardeve të aprovuara, futja në përdorim e impianteve të përpunimit të ujërave të ndotura në Kosovë ka ndikuar që të shtohet vëllimi i punës së ARRU. Për këtë arsye në ARRU është e domosdoshme të punësohen në një afat sa më të shkurtër kohor **3 të punësuar të rinjë** (1person për Departamentin Ligjor, 1person për Njësinë e Inspektimit dhe 1person për Departamentin e Tarifave).

Bashkëpunimi ndër institucional:

- Nga këndvështrimi i ARRU, komunikimi jo i mirë midis institucioneve lidhur me investimet në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotura, vlerësohet të jetë problem madhor i sektorit. Investimet në infrastrukturë të ujit dhe ujërave të ndotura të cilat financohen nga komunat apo Qeveria e Kosovës shpesh nuk reflektojnë prioritetet e prezantuara nga KRU-të në planet e tyre të biznesit dhe planet e menaxhimit të aseteve. Po ashtu problematike është edhe shpërndarja e investimeve nëpër regjione.
- Bashkëpunimi dhe komunikimi për sa i përket integritetit të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë nën menaxhimin e KRU-ve. Qëllimi është që sistemet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotur të menaxhohen nga KRU-të; pra, të operohen dhe mirëmbahen nga KRU-të e jo nga operator të palicencuar.
- Skadimi i lejeve ujore për shfrytëzimin e burimeve të ujit dhe ngërqi i krijuar midis MMPHI dhe KRU-ve, ka ndikuar që kjo çështje të prolongohet që nga shtatori/ tetori i 2023. Edhe

përkundër takimeve të organizuara kjo çështje mbetet e bllokuar dhe pa një perspektive për zgjidhje. Kjo do të vështirësojë procesin e licencimit të KRU-ve në vitin 2026, pasi pajisja me leje ujore është një prej dokumenteve kryesore i kërkuar për licencim.

Hartimi i planeve strategjike të KRU-ve:

Infrastruktura e ujit dhe ujërave të ndotura është e rëndësishme për ofrimin e shërbimeve të sigurta për konsumatorët. Për të mirëmbajtur nivelin e shërbyeshmërisë së këtyre sistemeve, kërkohet që ofruesit e shërbimeve të kenë të hartuar plane afat mesme dhe afatgjata për investime në infrastrukturë.

Sipas kornizës ligjore dhe rregullative, KRU-të janë të obliguara të hartojnë dhe të zbatojnë Planin e Biznesit (PB), Planin e Menaxhimit të Aseteve (PMA), Planin Afatgjatë të Investimeve (PAI), Planin për Menaxhimin e Thatësisë (PMTh) dhe Planin për Furnizim me Ujë në Situata Emergjente (PFUSE).

Në vitin 2023/2024/2025 ARRU ka kërkuar dhe ka ofruar mbështetje për KRU-të për avancim të mëtejshëm të Planit të Menaxhimit të Aseteve. Në përgjithësi vërehet mungesë e kapaciteteve profesionale të KRU-ve për të hartuar planet e tilla.

7. RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit financohet nga Taksat Vjetore të Licencës (TVL) të cilat ofruesit e shërbimeve janë të obliguar të paguajnë për shërbimet ndaj ARRU-së. Taksat vjetore të licencës transferohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

7.1 TË HYRAT

Lartësia e taksave vjetore të licencës për vitin 2025 ka qenë 540,799.00 Euro dhe është prezantuar në tabelën 11.

Tabela 11. Të hyrat e ARRU-së nga TVL

Të hyrat nga Taksat Vjetore të Licencimit (TVL)	Të planifikuara (EURO)	Të arkëtuara (EURO)
Të hyrat nga taksa vjetore e licencimit për vitin 2025	540,799.00	519,795.00
Gjithësej		519,795.46

7.2 BUXHETI

Buxheti i ARRU-së për vitin 2025 është përmbledhur në tabelën 12. Buxheti i propozuar nga ARRU është aprovuar nga Ministria e Financave.

Tabela 12. Buxheti i ARRU-së

Buxheti	I popozuar nga ARRU (EURO)
Paga dhe mëditje	254,923.00
Mallra dhe shërbime	143.000.00
Shpenzime kapitale	100,000.00
Shërbime komunale	3.503.00
Gjithësej	504.426.00

7.3 SHPENZIMET BUXHETORE

Për realizimin e aktiviteteve gjatë vitit 2025 ARRU ka shpenzuar këto shuma sipas aktiviteteve ekonomike:

Tabela 13. Realizimi i shpenzimeve

Shpenzimet	Shpenzimet (EURO)	Suficiti (EURO)	Përqindja e realizimit
Paga dhe mëditje	231,665.00	0.00	100.0%
Mallra dhe shërbime	137,755.00	5.245.00	96.33%
Shpenzime kapitale	44,580.00	55.420.00	44.58%
Shërbime komunale	1.977.00	1.526.00	56.43%
Gjithësej	415,977.00	62,191.00	82.46%

Niveli i realizimit të shpenzimeve krahasuar me buxhetin e aprovuar, pa përfshirë shpenzimet kapitale, është përmbushur në nivelin 82.46%.

8. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

ARRU e ka pranuar raportin e auditimit nga kompania që ka kryer auditimin e financave për vitin fiskal 2025. Opinioni i auditimit është cilësuar si “Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore”, ndërsa Konkluzioni për pajtueshmërinë është cilësuar si në vijim: “proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare”.

I njëjti Opinion dhe Konkluzioni për pajtueshmërinë janë dhënë edhe në raportin e auditimit për vitin fiskal 2024.

SHTOJCA 1: TË DHËNAT E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Në këtë shtojcë do të jepen disa të dhëna rreth performancës së KRU-ve për vitin 2025. Duhet të sqarohet se treguesit e performancës operative dhe financiare ende nuk janë audituar nga ARRU, pasi ky proces fillon në muajin prill, pasi të ketë përfunduar periudha e raportimit të KRU-ve tek institucionet përkatëse.

SH-1.1: ANKESAT E KONSUMATORËVE

Në tabelën 14 është paraqitur numri i ankesave të pranuar nga konsumatorët për vitin 2021 deri 2025, ankesat që janë zgjidhur nga Komisioni për Zgjidhje të Ankesave të Konsumatorëve (KZAK) dhe numri i proceseve gjyqësore.

Tabela 14. Numri i ankesave të konsumatorëve

#	Përshkrimi i aktivitetit	2021	2022	2023	2024	2025
1	Numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët Konsumatorëve (KZAK)	272	322	438	752	460
2	Numri i takimeve të mbajtura të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të	130	104	69	76	99
3	Gjithësej numri i ankesave të zgjidhura	252	322	431	572	588
4	Numri i padive të parashtruara nga konsumatorët në gjykatën themelore dhe në gjykatën e apelit	25	54	46	25	20
5	Pjesëmarrja në seanca gjyqësore	27	53	78	51	46

SH-1.2: TREGUESIT E PERFORMANCËS TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Cilësia e ujit të furnizuar nga ofruesit e shërbimeve të ujit

Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë raportuar tek ARRU nga Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik (QRSHP), të cilat funksionojnë në kuadër të Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë (IKSHPK) dhe janë përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 15. Kualiteti i ujit – përputhshmëria me standardet

KRU	Përshtatshmëria e kualitetit të ujit 2025 (%)	
	Testet kimiko-fizike	Testet bakteriologjike
PRN	96.9%	100%
PZ	99.3%	99%
PE	97.2%	99.9%
MIT	100%	100%
GJA	100%	100%
FE	97.2%	94.3%
GJI	100%	100%

Në nivel sektori:

- Përshtatshmëria bakteriologjike është 99.5%.
- Përshtatshmëria fiziko-kimike 98.6%.

Shenim: Monitorimi i kualiteti i ujit që furnizohet tek konsumatorët sipas UA 10/2021 është përgjegjësi ekskluzive e KRU-ve (monitorimi operacional) dhe IKSHPK (monitorimi i përputhshmërisë). Të gjitha KRU-të, përveç KRU Mitrovica, kanë laboratorë të akredituar. Gjatë vitit 2025 janë analizuar gjithsej 17,310 mostra, prej të cilave janë testuar 9,494 mostra për parametrat bakteriologjik dhe 7,816 mostra për parametrat fiziko-kimik.

Duhet potencuar se tek parametri i kualitetit të ujit për vitin 2025 ka pasur një progres krahasuar me vitin 2024.

Prodhimi, faturimi dhe uji i pa faturuar (UPF)

Prodhimi i ujit i referohet vëllimit të ujit të përpunuar që është futur në sistem, faturimi i ujit nënkupton ujin që iu është faturuar (shitur) konsumatorëve, ndërsa uji i pa faturuar nënkupton vëllimin e ujit që nuk është faturuar dhe që nuk sjellë të ardhura, i njohur si humbjet e ujit. Në figurën 3 është paraqitur vëllimi i ujit të prodhuar, të faturuar dhe i pafaturuar për vitin 2017- 2025.




Figura 3. Uji i prodhuar, faturuar dhe i pa faturuar (humbjet e ujit) në nivel sektori

Në vitin 2025 uji i pafaturuar (uji i humbur) ka pasur trend të njëjtë si në vitin 2024. Duhet theksuar se të gjitha KRU-të prej vitit 2024 raportojnë ujin e prodhuar sipas matjes. Edhe në vitin 2025 shitjet e ujit në nivel sektori janë rritur për 2.1% krahasuar me vitin 2024. Pra ky trend pozitiv i shitjes së ujit po vazhdon dhe është inkurajues.

Uji i pafaturuar i shprehur në % për KRU-të individuale është prezantuar në figurën 4.




Figura 4. Humbjet e ujit sipas regjioneve (%)

Siç mund të vërehet nga figura 4, KRU Hidrodrini dhe KRU Hidroregjioni Jugor kanë humbjet më të larta prej 79%, përkatësisht 76%. Të 5 (pesë) KRU-të tjera kanë mbajtur ose kanë zvogëluar humbjet e ujit krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, humbjet e ujit shprehur në përqindja janë shumë të larta.

Për të pasur një pasqyrë rreth kompleksitetit të humbjeve të ujit dhe për të krahasuar nivelin e humbjeve të ujit në Kosovë me shtetet e regjionit (Ballkan) dhe disa nga shtetet e BE, në tabelën 16 janë prezantuar të dhënat për humbjet e ujit. Në regjionin e Ballkanit, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina raportojnë nivele më të ulëta të humbjeve të ujit, por duhet theksuar se asnjëri prej këtyre 2 shteteve nuk kanë rregullator të pavarur për auditim të dhënave dhe raportim të besueshëm të dhënave. Të dhënat raportohen nga ministritë e linjës pa auditim të dhënave. Ndërsa krahasuar me 4 shtete tjera të Ballkanit, Kosova qëndron mjaftë mirë. Kosova, për nga niveli i humbjeve, krahasohet me Bullgarinë dhe në Rumaninë, ndërsa është shumë më keq se shtetet tjera të BE.

Tabela 16. Norma e UPF nëpër shtetet e regjionit dhe të BE

Shtetet e regjionit	UPF (%)	Shtetet e evropiane	UPF%
Shqipëria	65%	Gjermania	10%
Maqedonia e Veriut	62%	Finlanda	17%
Mali i Zi	68%	Polonia	25%
Bosna e Hercegovina	45%	Austria	15%
Serbia	42%	Suedia	17%
Kosova (2024)	63%	Çekia	20%
		Norvegjia	20%
		Belgjika	19%
		Bullgaria	61%
		Rumania	53%
		Italia	39%
		Franca	25%
		Mbretëria e Bashkuar	18%

Numri i konsumatorëve

Nga figura 5 shihet një rritje e shpejtë e numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit, më tepër se dyfishim i numrit të konsumatorëve për 15 vite. Është e qartë se këtë trend të shpejtë të rritjes së numrit të konsumatorëve nuk po mund ta përcjellin KRU-të me infrastrukturë adekuate dhe me nivel të shërbimeve që iu ofrojnë konsumatorëve. Megjithatë, kjo rritje i atribuohet kryesisht ndërtimeve të reja, ku çdo njësi e re banesore regjistrohet si konsumatorë, e KRU Prishtina në këtë aspekt ka rritjen më të madhe sa i përket numrit të konsumatorëve.




Figura 5. Trendi i rritjes së numrit të konsumatorëve përgjatë viteve

Eficientia e faturimit dhe arkëtimit

Efikasiteti i faturimit dhe arkëtimit në nivel të sektorit për 5 vitet e fundit është përmbledhur në tabelën 17.

Tabela 17. Përmbledhje e të dhënave të faturimit dhe arkëtimit për sektorin

Viti	Faturimi (Euro)	Arkëtimi (Euro)	Raporti Arkëtimi/Faturimi
2019	37,014,636	33,204,512	90%
2020	36,028,831	30,371,368	84%
2021	37,555,661	35,614,516	95%
2022	39,331,433	36,197,211	92%
2023	40,314,299	40,784,705	101%
2024	41,140,950	43,357,690	105%
2025	48,076,276	45,781,085	95.2%

Prezantimi i shkallës së arkëtimit për periudhën 2010-2024 është paraqitur në figurën 6. Nga kjo figurë shihet se ka pasur një trend të vazhdueshëm rritës të faturimit, e veçanërisht të arkëtimit.




Figura 6. Trendi i arkëtimit përgjatë viteve

Për dallim nga vitet paraprake ku shkalla e arkëtimit ka qenë relativisht e ulët, në vitin 2023 dhe 2024, KRU-të kanë qenë shumë më aktive në arkëtimin e faturave për shërbimet e ujit. Shkalla e lartë e arkëtimit mbi 100% në vitin 2023 dhe 2024 tregon që kompanitë kanë mbledhur borzje të vjetra si rezultat i shfrytëzimit të mekanizmit të përmbaruesve në arkëtimin e borzjeve. Në vitin 2025 ka pasur një rënie të arkëtimit prej 9% krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, në vlerë absolute, performanca e arkëtimit ka shënuar rritje. Në nivel sektori janë arkëtuar rreth 45.8 milionë euro, që përfaqëson një rritje prej rreth 2.4 milionë euro krahasuar me vitin paraprak. Rënia e normës së arkëtimit në përqindje, përkundër rritjes në vlerë monetare, shpjegohet me faktin se gjatë vitit 2025 ka pasur rritje më të theksuar të faturimit, me një normë më të lartë sesa rritja e arkëtimit.

Në nivel të KRU-ve të dhënat e arkëtimit për vitin 2023 dhe 2024 janë prezantuar në tabelën 18.

Tabela 18. Të dhënat e arkëtimit

Viti	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Arkëtimi i realizuar	107%	102%	106%	104%	90%	64%	100%	87%	106%	104%	98%	101%	114%	104%
Caku i vendosur me proces tarifor	94%	96%	94%	96%	94%	97%	88%	96%	95%	96%	93%	96%	94%	97%

Është inkurajuese që 6 (gjashtë) KRU, përveç KRU Hidrodrini, kanë tejkaluar pragun e arkëtimit të vendosur nga ARRU me proces tarifor.

Struktura e shpenzimeve operative

Mbikëqyrja e realizimit të kostove operative të ofruesve të shërbimeve është proces shumë i rendësishëm për ARRU-në. Tradicionalisht, dy nga kategoritë kryesore të shpenzimeve janë pagat dhe energjia. Në vitin 2024, këto dy kategori përbënin rreth 80% të shpenzimeve totale operative, ndërsa në vitin 2025 kjo pjesëmarrje është rritur në 82.92%. Pjesëmarrja e shpenzimeve operative për vitet 2024 dhe 2025 është paraqitur në figurat 7 dhe 8.

Figura 7. Struktura e shpenzimeve operative 2024 dhe 2025




Figura 7. Struktura e shpenzimeve operative 2024




Figura 8. Struktura e shpenzimeve operative 2025

Shpenzimet operative të realizuara kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë vitit 2025 krahasuar me vitin 2024. Në vitin 2025 shpenzimet kanë qenë rreth 41.2 milion Euro, krahasuar me 34.9 milion euro në vitin 2024, që paraqet një rritje prej 6.3 mil. euro apo 18.3%. Kjo rritje është

evidentuar në të gjitha KRU-të pa përjashtim, duke reflektuar presionin e përgjithshëm mbi kostot operative të sektorit.

Struktura e shpenzimeve operative tregon se pjesën më të madhe e përbëjnë shpenzimet e personelit me pjesëmarrje 57.4% të totalit të shpenzimeve operative. Krahasuar me vitin 2024, këto kosto janë rritur për 1.9 milion euro apo 9%. Norma më e lartë e pjesëmarrjes së pagave në totalin e shpenzimeve operative është evidentuar tek KRU Bifurkacioni dhe KRU Gjakova (75%), ndërsa norma më e ulët tek KRU Prishtina (55%) dhe KRU Mitrovica (58%). Të gjitha KRU-të, me përjashtim të KRU Hidrodrini, kanë shënuar rritje të shpenzimeve të personelit gjatë vitit 2025 krahasuar me vitin 2024.

Kategoria e dytë më e madhe e shpenzimeve është kostoja e energjisë elektrike, e cila përbën 25.5% të totalit të shpenzimeve operative. Në raport me vitin 2024, kjo kategori ka shënuar rritje të theksuar prej 73%, përkatësisht 4.4 milion euro më shumë në vlerë monetare, rritje e cila lidhet krejtësisht me ritjen e kostos së energjisë elektrike, të cilat pastaj kanë reflektuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove operative të ofruesve të shërbimeve të ujit. Së bashku, kostoja e pagave dhe ajo e energjisë përbëjnë rreth 83% të totalit të shpenzimeve operative, çka tregon përqendrim të lartë të kostove në dy kategori kryesore dhe rrit ndjeshmërinë e sektorit ndaj ndryshimeve në tregun e punës dhe energjisë.

Ndërkaq, shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparim gjatë vitit 2025 përbëjnë vetëm rreth 2.4% të totalit të shpenzimeve operative, duke mbetur në nivel pothuajse të njëjtë me vitin 2024 dhe duke qenë pothuajse kategoria me pjesëmarrjen më të ulët. Ky nivel relativisht i ulët i këtyre shpenzimeve mund të ketë implikime afatgjata në qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e infrastrukturës ujore.

Efikasiteti i stafit të KRU-ve

Tregon numrin e punonjësve (stafit) të rregullt i angazhuar në shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit, për të ju shërbyer 1000 konsumatorëve. Sa më e ulët të jetë ky koeficient, tregon efikasitet më të madhe të stafit të KRU-së.




Figura 9. Efikasiteti i stafit sipas regjioneve

Për sa i përket kompanive individuale, shihet që vetëm KRU Gjakova dhe KRU Hidroregjioni Jugor aktualisht kanë koeficient > 5 për sa i përket efikasitetit të stafit, ndërsa 5 kompanitë tjera KRU Hirdrodrini, KRU Mitrovica, KRU Bifurkacioni, KRU Hidromorava dhe KRU Prishtina kanë koeficient < 5 për sa i përket efikasitetit të stafit. KRU Prishtina me koeficient 3.66 është dukshëm nën mesataren e sektorit, pjesërisht mund të shpjegohet me numër shumë të madh të objekteve banesore të ndërtuara, ku secila njësi banesore (apartament) brenda një objekti regjistrohet si konsumatorë i ri.

Efikasiteti i stafit për periudhën 2010-2023 është paraqitur në figurën 10.




Figura 10. Efikasiteti i stafit sipas viteve

Në nivel sektori vërehet një trend pozitiv për sa i përket këtij treguesi të performancës, përmirësimi i këtij koeficienti vjen kryesisht si rezultat i rritjes së numri të konsumatorëve të regjistruar brenda zonës ekzistuese të shërbimit.

Ndërsa krahasimi i efikasitetit të stafit në Kosovë me shtetet e regjionit është paraqitur në tabelën 19.

Tabela 19. Krahasimi i normës së punës dhe efikasitetit të stafit për disa shtete të regjionit

Shteti	Viti	Efikasiteti i stafit (staf/1000 kons.)
Kosova	2023	4.36
Shqipëria	2020	5
Maqedonia	2016	3
Mali i Zi	2020	5
Bosnja e Hercegovina	2020	7
Serbia	2020	4
Kroacia	2015	3

Praktikat e mira ndërkombëtare sugjerojnë një normë më të ulët se 5 punëtorë që ju shërbejnë 1000 konsumatorëve, norma më e lartë se 5 mund të jetë indikatorë i mbi punësimit.

Norma e mbulimit të punës

Norma e mbulimit të punës matë aftësinë e një kompanie për të mbuluar kostot operative nga të ardhurat operative. Kjo do të thotë se menaxhimi i qëndrueshëm financiar kërkon që ky raport të jetë më i lartë se 1. Raporti llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat operative me kostot operative, përfshirë subvencionin, por nuk përfshin amortizimin, mirëmbajtjen kapitale dhe provizionimin e borxheve të këqija.




Figura 11. Norma e mbulimit të punës

Nga figura 11 shihet se për vitin 2024 të gjitha KRU-të kanë realizuar normën e mbulimit të punës më të madhe se 1, që është tregues i mirë, që pasqyron qëndrueshmërinë operative afatshkurtër të KRU-ve. Megjithatë, meqenëse raporti mbetet mbi 1, sektori vazhdon të jetë financiarisht i qëndrueshëm në aspektin operacional, pra është në gjendje t’i mbulojë shpenzimet operative nga të hyrat e arkëtuara.

Të gjitha KRU-të, krahasuar me vitin paraprak, kanë shënuar përkeqësim të këtij treguesi, si pasojë e rrijës shumë të lartë të kostove operative, veçmas të kostos së energjisë elektrike, në raport me të hyrat e arkëtuara dhe projeksionet. Zvogëlimi i vlerës së këtij treguesi, megjithatë, sinjalizon ngushtim të hapësirës financiare dhe mundësi më modeste për realizimin e investimeve domethënëse nga mjetet vetanake. Përkeqësimi më i theksuar është evidentuar tek KRU Hidroregjioni Jugor. Kjo situatë e ekspozon kompaninë ndaj rrezikut të deficitit operacional në rast të rritjes së mëtejme të kostove apo rënies së arkëtimit, dhe kufizon ndjeshëm kapacitetin për investime pa mbështetje të jashtme (subvencione operative).

SHTOJCA 3: TARIFAT PËR UJË DHE UJËRA TË NDOTUR

Në tabelën në vijim janë dhënë tarifat për ujë dhe ujëra të ndotur për të gjitha KRU-të dhe kategoritë e konsumatorëve.

Tabela 20. Përmbledhje e tarifave për vitin 2025 dhe 2026

Kompania	Konsumatorët	Tarifat	Njësia	2025	2026
PR	Shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.45	0.6345
		Kanalizim	EUR/m ³	0.08	0.1279
	Jo-shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.62	0.8248
		Kanalizim	EUR/m ³	0.17	0.2813
PZ	Shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.40	0.5680
		Kanalizim	EUR/m ³	0.15	0.1911
	Jo-shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.56	0.7384
		Kanalizim	EUR/m ³	0.32	0.4205
PE	Shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.28	0.3949
		Kanalizim	EUR/m ³	0.15	0.1558
	Jo-shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.39	0.5133
		Kanalizim	EUR/m ³	0.33	0.2961
MIT	Shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.39	0.5324
		Kanalizim	EUR/m ³	0.10	0.1354
	Jo-shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.55	0.6921
		Kanalizim	EUR/m ³	0.22	0.2979
GJA	Shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.39	0.5219
		Kanalizim	EUR/m ³	0.15	0.1843
	Jo-shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.55	0.6784
		Kanalizim	EUR/m ³	0.32	0.4055
FE	Shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.39	0.5345
		Kanalizim	EUR/m ³	0.11	0.1345
	Jo-shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.54	0.6948
		Kanalizim	EUR/m ³	0.23	0.2959
GJI	Shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.39	0.5463
		Kanalizim	EUR/m ³	0.12	0.1463
	Jo-shtëpiak	Ujësstellës	EUR/m ³	0.55	0.7101
		Kanalizim	EUR/m ³	0.27	0.3218

Adresa e ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Rruga: Gazmend Zajmi, Nr. 85-87

E-mail: info@arru-rks.org

Ueb: <http://www.arru-rks.org/>